

MESAZHI I KRYETARIT TË KOMUNËS

Komuna e Vithkuqit, me eksperiencën që ka fituar gjatë kësaj dekade, po kalon fazën e tranzicionit dhe po hyn në një zhvillim të qëndrueshëm.

Të ndërgjegjësuar për këtë realitet të ri dhe në harmoni me studimin, zbërthimin dhe adaptimin në kushtet e komunës sonë të Strategjisë Rajonale të Zhvillimit për Qarkun e Korçës, unë mendoj se ishte momenti më i natyrshëm, favorizues dhe i përshtatshëm për të ndërmarrë iniciativën e hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal të komunës së Vithkuqit.

Plani i Zhvillimit Lokal do të krijojë një hapësirë të re zhvillimi për komunën tonë. Ne kemi ambicjen që duke kuptuar objektivat strategjike të fushave prioritare të zhvillimit, banorët e komunës sonë në një të ardhme të afërt do të kenë një mirëqënie më të lartë dhe do të jetojnë në një ambjent me shpresëdhënës për të rinjtë dhe të vegjlit e tyre.

Por më duhet të pranoj se organizimi dhe realizimi i një procesi të tillë, me pjesëmarrje kaq masive e cilësore njëherësh nuk mund të kryhej prej nesh pa mbështetjen e Këshillit të Komunës, administratës së komunës, dhe komunitetit të Vithkuqit. 20 anëtarë të Grupit të Planifikimit të Zhvillimit Lokal dhe 7 anëtarë të Grupit të Vlerësimit dhe Monitorimit me Pjesëmarrje kontribuan shumë ore të kohës së tyre në hartimin e Planit të Zhvillimit Lokal. Mbi 155 përfaqësues të komunitetit morën pjesë në Panairin e Ideve të zhvilluara në fshatra dhe opinionin e tyre për zhvillimin e komunës dhe të fshatrave të tyre, opinionin e cili u integrua në Visionin e Komunës dhe në objektivat strategjike. Gjumnazistët tanë ndihmuan në intervistimin e 145 familjeve që u realizua për të grumbulluar informacion për kënaqshmërinë e komunitetit në lidhje me shërbimet që ofron komuna. Të gjitha këto përpjekje janë pasqyruar në këtë plan bashkëkohor me vizion që do të shërbejë komunitetit tonë në të ardhmen.

Dhe së fundi, deklaroj me kënaqësi e siguri të plotë se kemi hartuar një plan mobilizues, cilësor e ambicioz dhe se kemi kryer një shkollë për të qeverisur më mirë dhe të gjithë së bashku.

Faleminderit



Gjergji Topi
Kryetari i Komunës Vithkuq

FALENDERIME

Hartimi i këtij plani nuk do të ishte i mundur pa kontributin dhe dedikimin e Këshillit të Komunës dhe të anëtarëve të përmendur më poshtë:

KËSHILLI I KOMUNËS

Adem Bregu, Maksi Ajdini, Evelina Kurtiqi, Dhori Tona, Stavri Tona, Petraq Shore, Sulejman Alushi, Mestan Topciu, Foto Hanxhara, Albert Zeqo, Vasil Shore, Xhemal Velikollari.

KOMUNA VITHKUQ:

Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal (PZHL)

Kryetari, (i zgjedhur nga grupi i PZHL) – Gjergji Topi, Kryetari i Komunës
Antarë të Këshillit të Komunës - Evelina Çollaku; Foto Hanxhara; Xhemal Velikollari;
Adem Bregu; dhe Mestan Topçiu
Personel nga administrata e komunës – Liljana Theodhori; Luiza Grabocka;
Theodharaq Buba; Dhimitraq Gjylahu
Banorë me profesione të ndryshme, nga zona të ndryshme të komunës - Zhaneta
Grabocka; Filloreti Grabocka; Miranda Toma; Lefter Bendo; Petraq Shore; Stavri
Shore; Margarita Bendo; Athina Shore;
Përfaqësues nga fshatrat: Robert Ropi; Zalo Meckollari; Kujtim Lamçe; Emill Demko;

Grupi i Monitorim Vlerësim me Pjesëmarrje (MVP):

Kryetare – Pavlina Shore
Staf i komunës – Pavlina Shore; Gurali Iljazi
Përfaqësues të komunitetit – Robert Shore; Polikron Miho; Koço Qirjo; Evelina Kurtiqi;
Kiço Shore
Numri total i anëtarëve në grupin e MVP: 7 anëtarë

Hartimi i Planit të Zhvillimit Lokal u bë i mundur edhe nga bashkëpunimi i frytshëm me Fondin e Zhvillimit Shqiptar (FZSH). Si pjesë e programit të rritjes së kapaciteteve të qeverisjes lokale nën Projektin Punët e Komunitetit II (të financuar nga Banka Botërore), FZSH përgatiti metodologjinë dhe një strukturë për planifikimin e zhvillimit lokal dhe përzgjedhi komunën tonë si komunë pilote për të testuar këtë metodologji. Gjatë punës së saj, FZSH përfshiu Institutin Urban (Washington, DC) dhe Institutin e Kërkimeve Urbane (IKU) që të punonte me personelin e FZSH në hartimin e metodologjisë dhe të monitoronte zbatimin. Në vazhdim të kësaj, FZSH nënkontraktoi MixTecnica (Tiranë) për të ofruar koordinimin, asistencën teknike dhe monitorimin e procesit të hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal në Vithkuq.

HYRJE

Në 2005 komuna e Vithkuqit u angazhua në procesin e hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal me qëllim që të përcaktonte një vizion të qartë për të ardhmen e komunës - dhe të caktonte hapat e veprimit për të arritur këtë vizion.

Hartimi i Planit të Zhvillimit Lokal u realizua në një proces të hapur dhe transparent duke përfshirë këshillin e komunës, stafin e komunës, grupet e këshillimit dhe të ndjekjes, të krijuara në nivel komune dhe fshati si dhe anëtarë të tjerë të komunitetit në krijimin e një vizioni afatgjatë zhvillimi, objektivave strategjike si dhe hapat/projektet konkrete të cilat do të çojnë komunën e Vithkuqit drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Pse Duhet te Hartojmë një Plan për Zhvillimin Lokal?

Planifikimi i zhvillimit lokal është një proces që i jep mundësinë komunës sonë — dhe banorëve që ajo përfaqëson — të planifikojnë, zbatojnë dhe kontrollojnë të ardhmen e tyre. Një Plan Zhvillimi Lokal jep informacion mbi drejtimin e veprimeve drejt zhvillimit të një komuniteti. PZHL është një hartë për t'u ndjekur nga të zgjedhurit, personeli i komunës, dhe komuniteti në tërësi për ti dhënë formë të ardhmes së dëshiruar prej tyre. Planifikimi i Zhvillimit Lokal ka të bëjë me të menduarin, të vepruarin dhe të parashikuarin strategjik të veprimeve që duhet të ndërmerim në mënyrë që të realizojmë qëllimet e dëshirueshme.

Një plan zhvillimi është efektiv kur ne e kuptojmë se çfare po bëjmë, kujt i shërben, dhe sa mirë i plotëson nevojat e komunitetit. Kur bëhet mirë, planifikimi i zhvillimit lokal ka pjesëmarrjen e gjerë të komunitetit dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Kjo garanton që ne po përdorim burimet më të mira të mundshme në planifikimin e së ardhmes ashtu si edhe krijon një forum të gjerë për pjesëmarrje të shoqërisë, përkushtim dhe rritje të ndjenjës së pronësisë.

Qëllimet strategjike dhe hapat e veprimit të shprehura në Planin e Zhvillimit Lokal nuk janë vetëm autoritet e qeverisjes vendore. Komuna nuk mund të bëjë vetë gjithçka, dhe as nuk mund t'i adresojë vetëm të gjitha problemet e komunitetit. Kështu që, në Planin e Zhvillimit Lokal është idea që i gjithë komuniteti ka një kontribut për të dhënë në arritjen e një komune të qëndrueshme. Angazhimi dhe veprimet e komunitetit, grupeve dhe të interesuarve të tjerë janë mjaft të rëndësishme në arritjen e suksesshme të Vizionit të Komunës, qëllimeve dhe veprimeve që janë themelore në Planin e Zhvillimit Lokal.

Një PZHL është efektiv kur në mënyrë rigorozë përdoret që të planifikojë shërbime dhe projekte, identifikojë burimet, boshllëqet dhe nevojat fiskale, masë rezultatet e punës së qeverisë lokale, dhe ti komunikojë këto rezultate tek komuniteti. Ky është një proces dhe dokument me anë të të cilit komuniteti mund të vërë përpara përgjegjësisë udhëheqësit e tij në mënyrë që ti përgjigjet nevojave dhe prioriteteve të tij. PZHL siguron një përdorim efektiv të burimeve specifike të komunave në mënyrë që të bëhet sa më e mundur arritja e objektivave.

PER ÇFARE ËSHTË PLANI YNE I ZHVILLIMIT LOKAL?

Nje vizion i Përbashkët

Komuna jone përballet me shumë sfida për zhvillim dhe burime të pakta për ti përballuar ato – por gjithashtu ne kemi shumë mundësi. Detyra jonë është që t'i bashkojmë të gjitha burimet dhe komunitetin në një vizion të përbashkët për të cilin mund të mobilizojmë dhe të përdorim sa më mirë burimet tona njerëzore, natyrore dhe financiare. Për të arritur këtë, procesi ynë për hartimin e PZHL ftoi këshilltarët dhe komunitetin për "të pikturuar" të ardhmen tonë në 10–15 vitet e ardhshme. Rezultati i këtij aktiviteti ishte "Vizioni i Vithkuqit".

Një plan për të Ardhmen Tonë

E ardhmja jonë sigurisht që do të ndryshojë – dhe ne duhet të sigurohemi që ne jemi autorë të këtij ndryshimi duke iu kundërvënë situatave rrethore që përcaktojnë të ardhmen tonë. PZHL përmban qëllime dhe hapa veprimi të realizueshme, për të cilat ne jemi të sigurt që mund t'i arrijmë hap pas hapi në rrugën tonë për të përmbushur vizionin.

Katër shtyllat

Ne dëshironim të caktonim një rrjet të gjerë që të siguroheshim që të gjitha prioritetet e zhvillimit të përfshiheshin në PZHL. Kjo ishte arsyeja që e organizuam PZHL në bazë të katër fushave prioritare:

- Zhvillimi Ekonomik
- Zhvillimi Social
- Infrastruktura dhe Shërbimet Publike
- Qeverisja e Mirë

Një Komunitet, Shumë Zëra

Komuna jonë përbëhet nga shumë zëra – burra, gra, femijë, të vjetër, biznesmenë, fermerë e kështu me radhë. Ishte kritike për ne që të kuptonim shpesh se sa të ngjashme po aq dhe të ndryshme ishin nevojat dhe pritshmerite e këtyre grupeve. Proçesi i PZHL inkurajoi pjesëmarrjen e grave në grupet e këshillimit, dhe të gjithë përfaqësuesit e komunitetit u ftuan që të merrnin pjesë në hartimin e këtij plani.

Komunikimi me Publikun

Plani ynë i Zhvillimit Lokal është një bashkëbisedim me komunitetin. Ne morëm mendime dhe informacion nga komuniteti dhe shpresojmë që këto opinione janë të reflektuara në këto faqe. Ne kemi nevojë që të nxisim dialogun dhe opinionin e vazhdueshëm në mënyrë që të sigurohemi që po ndikojmë ashtu siç duhet tek komuniteti ynë.

Një panoramë më e gjerë

PZHL-ja jonë ka të bëjë me të menduarin në terma afatgjatë në lidhje me nevojat e zhvillimit të Vithkuqit. Sidoqoftë, ne u kujdesëm që të merrnim parasysh edhe Strategjinë Rajonale të Zhvillimit për Qarkun e Korçës që të siguroheshim që ishim në një linjë me Objektivat Rajonale dhe Kombëtare të Zhvillimit për Mijëjeçarin (OZHM). Në këtë

mënyrë PZHL-ja e Vithkuqit kontribon në arritjen e objektivave dhe prioriteteve kombëtare.

KUSH U PËRFSHI NË HARTIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT LOKAL


Për të pasur një proces të hapur dhe transparent, në hartimin e planit për zhvillimin e komunës Vithkuq, është synuar një pjesëmarrje e gjerë nëpërmjet krijimit të grupeve të këshillimit më bazë pjesëmarrjen e komunitetit. Pjesëmarrja e tyre ishte kyç për suksesin e hartimit dhe zbatimit të PZHL.

Grupi i Planit të Zhvillimit Lokal (grupi PZHL): Ky grup është përgjegjës për nxitjen, udhëheqjen, këshillimin dhe mbikqyrjen e hartimit të PZHL. Grupi i PZHL së Vithkuqit përfshiu 20 persona si : kryetari i komunës, përfaqësues të këshillit, përfaqësues nga administrata e komunës, përfaqësues të fshatrave si dhe përfaqësues nga komuniteti.

Nënkomitetet e Fushave Prioritare: Këto grupe përfaqësojnë katër shtyllat kryesore (zhvillimi ekonomik, zhvillimi social, infrastruktura dhe shërbimet publike dhe qeverisja e mirë) dhe janë përgjegjëse në përcaktimin e hapave të veprimit/projektet konkrete për fushat prioritare dhe hartimin e prefizibiliteteve dhe fizibiliteteve. Këto grupe mund të ftojnë dhe specialistë të tjerë të jashtëm që të japin ekspertizën e tyre në detajimin e hapave të veprimit/projekteve konkrete.

Grupi i Monitorim-Vlerësimit me Pjesëmarrje (grupi MVP): Grupi i MVP-së ngarkohet të punojë ngushtë me grupin e PZHL dhe nënkomitetet për të përcaktuar kriteret, vlerësuar procesin, caktuar matësat për realizimin e objektivave strategjike apo hapave të veprimit. Grupi monitoron edhe zbatimin e PZHL dhe raporton sukseset apo pengesat tek qeverisja vendore (komuna dhe keshilli i komunës) dhe komuniteti. Grupi i MVP përbëhet nga 7 persona që përfaqësojnë administratën e komunës dhe komunitetin.

Figura 1. Diagrama që demonstroi lidhjen midis grupeve të këshillimit



SI E REALIZUAM KËTË PROÇES? DHJETË HAPAT PËR HARTIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT LOKAL

1. Garantimi i angazhimit lokal. Ky hap siguron që zyrtarët e qeverisjes vendore dhe personeli të njihen me qëllimet e projektit dhe në të njëjtën kohë të angazhohen në këtë projekt. Në 20 maj, u bë prezantimi i projektit në Këshillin e Komunës së Vithkuqit. Gjatë këtij takimi u zgjodhën 3 anëtarë të këshillit si pjesëmarrës të grupit të PZHL.

2. Ofrimi i Asistencës. Gjatë këtij hapi u orjentuan dhe trajnuan anëtarët e grupit të PZHL dhe MVP për strukturën dhe metodologjinë e PZHL/MVP. Trajnimi 2 ditor u organizua në 2-3 Qershor dhe përfshiu 25 pjesëmarrës.



3. Fillimi i Punës. Grupet e PZHL-së dhe MVP-së organizuan takime gjatë të cilave caktoan planin e aktiviteteve që do të ndiqnin, si dhe caktoan afatet kohore, rolet dhe përgjegjësitë për çdo anëtar të grupeve. Gjithashtu u organizua një fushatë komunikimi që përfshinte fletëpalosje me informacion për projektin dhe postera për panairët e ideve në fshatra.

4. Mbledhja e informacionit. Përpara se të mësojmë se ku po shkojmë ne duhet të dimë se ku jemi. Ky hap na lejon të bëjmë një vlerësim të situatës aktuale të komunës dhe të krijojmë një pamje më të plotë dhe të saktë të Komunës. Që këtu mund të fillojmë të mendojmë për të ardhmen e komunës. Kjo fazë ishte shumë e ngjeshur dhe kërkoi përkushtimin e grupit të PZHL si dhe të gjimnazistëve. Për shembull, anëtarë të grupit të PZHL plotësuan pyetësozin prej 14 faqesh për karakteristikat e komunës – cilat janë burimet tona natyrore/njerëzore, buxheti i komunës e kështu me radhë. Këto të dhëna u morën në zyrat e komunës apo në qark.

Numri i Familjeve të Intervistuar	
Cemicë	3
Gjanc	6
Leshnjë	14
Lubonjë	15
Panarit	32
Rehovë	6
Roshanj	2
Shtyllë	10
Vithkuq	57
Total	145

Gjimnazistët e Vithkuqit asistuan në anketimin e familjeve, anketim gjatë të cilit u mor informacion nga komuniteti mbi shërbimet që ofron komuna. Anketimi u realizua në 9 fshatra nga 15 fshatra që ka komuna. Familjet u zgjodhen në mënyrë të rastësishme në këto fshatra. Gjimnazistët luajtën një rol të rëndësishëm gjatë këtij procesi dhe duhet të vlerësohen për përpjekjet e tyre.


Dhe së fundi, u realizua analiza SWOC me këshillin e komunës në takimin e radhës. Kryetarët e fshatrave u përfshinë në këtë proces dhe dhanë mendime shumë të vlefshme. Analiza SWOC – Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Sfidat – lejoi të zgjedhurit lokal që të jepnin mendimet dhe opinionet e tyre për çfarë shkon mirë në komunë dhe çfarë nuk shkon siç duhet, si dhe të bënin sugjerime se si mund të përmirësoheshin fushat prioritare.

5. Panairët e ideve në fshatra. Për të marrë opinionin qytetar përveç anketimit u organizuan nga grupi i PZHL dhe Panairët e Ideve në Fshatra. Panairët e Ideve në fshatra u cilësuan si forume interaktive për të grumbulluar idetë dhe informacionet e banorëve dhe për ta përdorur këtë informacion në hartimin e PZHL. Panairët e ideve u organizuan nga anëtarë të grupit lehtësues të PZHL dhe grupit të MVP, dhe kryetarët e fshatrave.

Panairët e ideve u organizuan në 9 fshatra nëpër vende të hapura, të përshtatshme dhe komode për pjesëmarrësit (Referohu fig. 4). Në komunën e Vithkuqit morën pjesë nëpër

këto panairë 155 pjesëmarrës në total nga të cilët 33 ishin gra dhe një numër i konsiderueshëm të rinjsh të cilët dhanë një informacion shumë të vlefshëm.

Figura 2: Konceptimi i Panairit të Ideve në Fshatra.



6. Sintetizimi i të Dhënave. Me grumbullimin e të gjithë informacionit – profili i komunitetit, anketimi i familjeve, analiza SWOC me këshillin e komunës, dhe panairët e ideve në fshatra - u përgatit nga një paketë informacioni për rishikim për anëtarët e grupit të PZHL dhe MVP. Duke pasur këtë informacion, grupi i PZHL së Vithkuqit:

- Përcakttoi vizionin 10-15 vjeçar për komunën.
- Zgjedhi anëtarët për nënkomitetet e fushave prioritare.
- Finalizoi objektivat strategjike për çdo fushë prioritare pas propozimeve të Nënkomiteteve të Fushave Prioritare.
- Votoi për Vizionin dhe Objektivat Strategjike përfundimtare.




7. Puna e Nënkomiteteve Të Fushave Proritare. Ky hap përfshin planifikimin më në detaje të hapave të veprimit për çdo objektiv strategjik të fushave prioritare. Gjithashtu nënkomitetet u ngarkuan me detyrën e hartimit të prefizibiliteteve që të demonstrohej që hapat e veprimit dhe projektet ishin konkrete, kuptimplotë dhe të realizueshme. Takimet e katër nënkomiteteve të fushave prioritare u kryen në një periudhë kohore prej 3 javësh. Gjatë kësaj kohe grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje punoi me përcaktimin e indikatorëve të cilët u zgjedhën në bazë të aktiviteteve/projekteve që ishin përcaktuar nga nënkomitetet e fushave prioritare. E gjithë kjo punë u prezantua në grupin e PZHL i cili diskutoi planet e veprimit për çdo fushë prioritare, matjen e performancës si dhe hapat në vazhdim. Grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje bëri dhe një raportim mbi ecurinë e procesit si dhe sa mirë u arritën pritshmëritë e grupit të PZHL gjatë këtij procesi.

8. Ju Folët ne Ju Dëgjuam, a u Kuptuam Drejt? Takime me komunitetin dhe rishikimi i Këshillit të Komunës: në momentin që grupi i PZHL ka përfunduar draftin e PZHL, ne e prezantojmë atë në komunitet në mënyrë që të sigurohemi që kjo PZHL i përgjigjet nevojave të komunitetit. Kryetarët e fshatrave luajnë rol kryesor në këtë detyrë.

9. Integrimi me Proçesin e Buxhetit. Qëllimi i PZHL-së është që ti lejojë komunitetet që të drejtojnë dhe kontrollojnë të ardhmen e tyre. Megjithatë, kjo nuk mund të kuptohet e ndarë nga proçesi i hartimit të buxhetit, pasi ky është momenti kur buxheti i limituar alokohet në ato zëra që ka më tepër nevojë komuniteti. Në hartimin e buxhetit, personeli i komunës paraqet zgjedhje konkrete dhe opsione për të zgjedhurit lokal se si mund të shpenzohen sa më efektivisht paratë e komunitetit. Duke pasur të dhënat dhe informacionin nga komuniteti, grupi i PZHL paraqet një panoramë për zgjidhjet e mundshme.

10. Zbatimi dhe Monitorim-Vlerësimi i Vazhdueshëm. PZHL ka një plan të detajuar në të cilin janë përcaktuar edhe afatet kohore dhe përgjegjësitë. Grupi MVP është e ngarkuar me detyrën e monitorimit të progresit që bëhet për arritjen e rezultateve të matshme. Monitorimi do të bëhet rregullisht duke i lejuar grupin e PZHL, të zgjedhurit lokal, dhe personelin e komunës që të bëjnë ndryshime të nevojshme atëherë kur nevojitet. Progresi do të raportohet edhe në komunitet me mënyra të ndryshme – media lokale, takime me këshillin e komunës, dhe postera.

Figura 3. Struktura e proçesit të PZHL



CILI ËSHTË AFATI KOHOR PËR PLANIN E ZHVILLIMIT LOKAL?


PZHL përmban plane veprimesh afatshkurtër dhe afatgjatë. Vizioni përfshin një periudhë kohore prej 10-15 vjetësh. Sidoqoftë, për të qenë sa më realiste dhe që të sigurohemi që gjërat bëhen në mënyrën që duam ne, e kemi ngushtuar hapësirën e veprimit në 5 vjet. Çdo hap veprimi që paraqitet më poshtë ka një afat kohor për zbatim. Përputhja me këto afate kohore do të monitorohet nga grupi i monitorim vlerësimit me pjesëmarrje.


SI TA LEXOJMË PLANIN E ZHVILLIMIT LOKAL.

Publikimi i Planit të Zhvillimit Lokal përmban këto seksione:

- **Hyrjen** në të cilën shpjegohen qëllimi, pjesëmarrja dhe metodologjia.
- **Profili i komunitetit** që shpjegon në detaje situatën aktuale të komunës duke u bazuar në të dhënat objektive të grumbulluara nga Grupi i PZHL dhe që plotësohet me opinione në lidhje me anketën e familjeve të organizuar në Qershor 2005. Dhe aty ku nevojitet, janë shpjeguar dhe të dhëna nga Strategjia Rajonale e Zhvillimit për Qarkun e Korçës me qëllim krahasimi.
- **Indikatorët e Performancës** për çdo fushë prioritare do të na lejoje që të monitorojmë progresin e bërë në arritjen e objektivave strategjike.
- **Të Qënurit në një Drejtim** me Strategjinë Rajonale të Zhvillimit për Qarkun e Korçës tregon që Vithkuqi po kontribon në strategjitë e zhvillimit rajonal dhe kombëtar.

AFATET KOHORE NË TË CILAT U HARTUA PLANI I ZHVILLIMIT LOKAL PËR KOMUNËN E VITHKUQIT.





INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR KOMUNËN E VITHKUQIT

Komuna e Vithkuqit është njësi administrative e qarkut të Korçës. Ajo shtrihet në jug – perëndim të qytetit të Korçës, në një distancë prej 26 km (qytet – qendër e komunës).

Njihet si vendbanim që në Mesjetë. Treva e Vithkuqit është e banuar qysh në periudhen ilire. Për herë të parë Vithkuqi gjendet i regjistruar si fshat në vitin 1484.

Madhësia e Vithkuqit si qendër banimi në shek XV nuk na lejon të themi që kemi të bëjmë me një fshat të sapokrijuar pasi në regjistrimet e viteve 1568-1569, Vithkuqi ishte një nga vendbanimet me popullsi më të dendur (331 shtëpi/8000 banorë) në trevat e Shqipërisë juglindore (Voskopoja kishte 331 shtëpi, Përmeti kishte 125 shtëpi, dhe Korça vetëm 31 shtëpi).

Gjatë shekullit XVII Vithkuqi njihet si një qendër tregtare e zhvilluar me marrëdhënie brënda dhe jashtë vendit ku zhvillohet dukshëm zejtaria, blegtoria e më pak bujqësia. Njihen dhe lidhjet tregtare të Vithkuqarve me qytete më të zhvilluara të Evropës si: Vencia, Viena, Budapesti, etj... Gjatë kësaj kohe u ngritën dhe 18 kisha dhe 3 manastire. Ka pasur dy manastire, bibliotekë, shkolla e elementë të tjerë të qytetërimit që janë shkatërruar në vitet 1781, 1819, dhe 1823.



Komuniteti është i ndërgjegjshëm për çështjet që i përkasin arsimimit, duke konsideruar që Abetarja e parë në gjuhën shqipe u bë nga Naum Veçilharxhi, një personalitet i lindur në Vithkuq dhe që njihet dhe si nismëtari i Rilindjes Kombëtare.

Në kishat e Vithkuqit ndodhet një galeri e madhe pikturash. Në shek. XVII ka qenë një nga qendrat më të zhvilluara në rajon. Ka pasur monumente kulturore si Afresket e Manastirit të Shën Pjetrit e Pavlit të piktorëve Zografë. Në muret e Kishës së Shën Pjetrit është pikturuar "rrota e Historisë" ose Horoskopi. Kisha e Shën Mhillit është ndërtuar në 1682. Në këtë kishë ndodhet varri i pagëzimit. Të gjitha kishat kanë piktura të Konstandin Shpatarakut.

Në komunën e Vithkuqit sot numërohen 4 kisha të shpallura monumente kulture dhe të mbrojtura nga shteti.

1. SHOQËRIA (Kapitali Social)

a. Komuniteti dhe Dinamika e tyre

Lëvizja e popullsisë në Qarkun e Korçës gjatë 10 viteve të fundit është ndier edhe në komunën e Vithkuqit. Numri i familjeve (viti 2005) në komunë është 773 dhe duke u krahasuar me numrin e familjeve në vitin 2000 shihet se ka një emigrim të 270 familjeve gjatë pesë viteve të fundit. Kjo reflekton dhe tendencën e lëvizjes së familjeve brënda vendit nga zona malore në ato fushore apo emigrimit jashtë vendit. Nga 2,939 banorë, 17.6 % janë pensionistë dhe 10% janë në moshë shkollore (9 vjeçare dhe gjimnazi).. Në përgjithësi, në komunë ka 2,132 persona që janë apo mund të angazhohen në aktivitete për

Figura 1. Shpërndarja e Popullsisë

Fshati	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Vithkuq	438	470	908
Leshnjë	111	108	219
Gjanc	49	64	113
Rroshanj	21	31	52
Rehovë	98	106	204
Lubonjë	284	280	564
Shtyllë	76	87	163
Çemerricë	27	32	59
Panarit	238	221	459
Grabockë	39	35	74
Trebickë	31	36	67
Treskë	17	17	34
Kat-Statober	13	10	23
Komuna	1442	1497	2939

gjenerimin e të ardhurave. Sidoqfte shkalla e papunësisë në komunë është e konsiderueshme. Këto të dhëna mbështesin edhe prioritetet e komunës për përmirësimin ekonomik dhe shtimin e mundësive për punësim.

Migrimi i popullsisë brënda rajonit po gjithashtu për në Tiranë dhe jashtë vendit, ka rezultuar në uljen e popullsisë në disa fshatra. Tetë fshatra të komunës kanë më pak se 200 banorë. Kjo situatë krijon një dobësim të përgjithshëm të aktiviteteve ekonomike të këtyre fshatrave si dhe ul kapacitetet e tyre për tregti.

b. Arsimimi

Në komunën e Vithkuqit objektet arsimore janë të përqëndruara në tre qendra: Vithkuq, Lubonjë, dhe Panarit. Aktualisht Vithkuqi numëron tre shkolla 9-vjeçare në të cilën mësojnë 250 nxënës dhe ka 19 mësues dhe një shkollë të mesme me 41 nxënës dhe 4 mësues. Në komunë ka dhe 2 kopshte fëmijësh në Vithkuq dhe Lubonjë me një total prej 35 fëmijësh,

Qarku i Korçës ka mungesë mësuesish të kualifikuar veçanërisht në fshatra dhe zona të izoluar, gjë që ndikon direkt në cilësinë e të mësuarit dhe arsimimit në këto zona. Sidoqftë, raporti i mësuesve në shkollat 9 vjeçare është një mësues për 13 nxënës, që është më i ulët se mesatarja në qarkun e Korçës (17 nxënës për mësues).

Figura 2. Rënia e popullsisë në 2000-2005

Fshati	Nr. i familjeve në vite	
	2000	2005
Vithkuq	255	245
Leshnje	50	55
Gjanc	35	33
Rroshanj	21	14
Rehove	113	48
Lubonje	177	152
Shtylle	59	38
Çemernice	20	11
Panarit	203	125
Grabocke	33	19
Trebicke	34	16
Treske	25	11
Kat-Statober	18	6
Komuna (Total)	1043	773

Figura 3. Shpërndarja e shkollave, nxënësve dhe mësuesve në komunën e Vithkuqit

Fshati	Shkolla 9-vjeçare	Nxënës	Mësues	Shkolla të mesme	Nxënës	Mësues	Kopshte	Fëmijë	Edukat
Vithkuq	1	95	8	1	41	1	1		1
Lubonja	1	97	7	-	-	-	1		1
Panariti	1	68	4	-	-	-	-	-	-
Komuna	3	250	19	1	41	4	2	35	2

Komuniteti i Vithkuqit është i interesuar që të çoj më tej këto tradita, dhe synojnë në përmirësimin e cilësisë së arsimimit në këtë zonë.

Situata e përgjithshme, përse i përket arsimit, duket sikur ka ndryshuar pozitivisht nëse konsiderojmë opinionin qytetar ku 63.4% shprehen se janë “shumë të kënaqur” ose “te kënaqur” me gjëndjen e shkollës. Megjithatë 64 % e popullsisë shprehen se janë të pakënaqur me kushtet e kopshteve. Për më tepër, vendosja e disa fshatrave të komunës në distancë të largëta e bën të vështirë për nxënësit e këtyre fshatrave të udhëtojnë disa kilometra për të shkuar në shkollë.

Gjendja e Kopshteve dhe shkollave ne Komune





Figura 4. Opinioni Qytetar

Një problem tjetër është edhe mungesa e mjeteve dhe pajisjeve shkollore, veçanërisht e laboratorëve, duke shtuar dhe nivelin dhe metodat e mësimdhënies, kompetencën e mësuesve si dhe rishikimi i programit mësimor.

Në panairët e ideve të organizuar në fshatra gjatë muajit Qershor 2005, komuniteti shprehu një interes të madh në drejtim të rikonstruksionit të objekteve arsimore në Gjanc, Vithkuq, Shtyllë dhe Leshnjë. Komuna e Vithkuqit i është përkushtuar punës në shtimin e numrit të nxënësve që ndjekin shkollën, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, si dhe në parandalimin e braktisjes së shkollës.


c. Kultura dhe Koha e Lire

Komuna e Vithkuqit ka qenë një qendër e njohur dhe e rëndësishme e kulturës dhe me një trashëgimi të pasur kulturore. Aktualisht, Vithkuqi numëron një numër të konsiderueshëm kishash që mbrohen nga shteti si monumente kulturore. Megjithatë jeta kulturore e komunitetit nuk është në nivelin e duhur. Komuniteti është i pakënaqur dhe i mungojnë aktivitetet kulturore dhe artistike. Rreth 71% mendojnë se këto aktivitete mungojnë në komunë dhe i njëjti opinion është dhe për aktivitetet sportive, megjithëse ekziston një qendër sportive që operon në komunë.



d. Shërbimi Shëndetsor

Shërbimi shëndetsor në komunën e Vithkuqit realizohet nëpërmjet strukturave të shërbimit shëndetsor parësor. Sistemi shëndetsor në komunë përbëhet nga një qendër shëndetsore dhe 6 ambulanca ku punojnë 1 mjek dhe disa infermierë dhe mami. Ashtu si në gjithë qarkun e Korçës dhe në vendet më të ardhura të vogla, edhe në komunën e Vithkuqit sëmundjet infektive dhe përhapja e tyre janë një problem për komunitetin. Kjo situatë e bën të domosdoshme riorganizimin e strukturave shëndetsore parësore në fshatra që kanë mungesë të këtij shërbimi në mënyrë që të plotësoj standartet rajonale për zonat rurale. Megjithëse fshatrat kryesore kanë shërbim ambulator me infermierë dhe një doktor që shkon një herë në javë në fshatra për vizitë, prapë ka nevojë për përmirësimin e kujdesit shëndetsor, duke përfshirë një personel të kualifikuar. Gjithashtu këto ambulanca kanë dhe mungesë të pajisjeve të domosdoshme mjekësore dhe ilaçeve.




Në përgjithësi komuna vuan nga kushtet higjenike dhe kanalizimet. Pothuajse 40 % e komunitetit shpreh pakënaqësi për nivelin e higjenës në komunë në përgjithësi dhe kjo shifër rritet në 50% kur komuniteti pyetet në veçanti për fshatrat. Ky problem është ngritur më shumë se një herë në Panairt e Ideve në fshatra, veçanërisht në fshatrat Lubonjë, Shtyllë dhe Vithkuq.

Plani i Zhvillimit Lokal për Vithkuqin, ka përcaktuar disa objektiva dhe hapa veprimi konkrete për përmirësimin e situatës shëndetsore të komunitetit për të arritur standartet europiane.

e. Asistenca Sociale



Ka dy kategori njerzish që përfitojnë asistencë sociale: familjet pa të ardhura dhe familjet me të ardhura më të vogla se niveli i jetesës.

Komuna e Vithkuqit numëron 56 familje (7.2 %) që përfitojnë asistencë sociale. Sikurse shihet dhe në figurën 7 këto familje janë të shpërndara në 8 fshatra. Pjesa më e madhe e atyre që përfitojnë asistencë sociale ndodhen në Panarit ku numri arrin deri në 31 familje (duke përfaqësuar kështu 25% të numrit total të familjeve në këtë fshat)



f. Cilësia e Jetës

Me gjithë këto sfida në fushën e arsimit dhe shëndetit, në përgjithësi banorët e komunës së Vithkuqit janë të kënaqur me cilësinë e jetës, 60% e tyre shprehen që janë shumë të kënaqur ose të kënaqur me cilësinë e jetës dhe 68% besojnë se gjendja e komunës ka ndryshuar tre vitet e fundit.



2. Ekonomia

a. Situata e Përgjithshme

Figura 10. Shpërndarja e krahut të punës sipas arsimimit

Emërtimi	Të punësuar	Të papune
Me arsim të lartë		
Ekonomist	-	1
Agronomë	2	1
Inxhinjerë	1	-
Mësues	9	1
Mjek	1	-
Të tjerë	1	1
Totali	18	4
Me arsim të mesëm		
Mësues	10	-
Ekonomistë	3	7
Agronomi+Zootekni	5	25
Veteriner	1	3
Totali	19	25

Burimet e konsiderueshme njerëzore e natyrore të komunës mundësojnë plotësisht një zhvillim të qëndrueshëm të komunës së Vithkuqit. Komuna numëron 2,132 banorë (72.5 % e popullsisë) që janë aktivë si forcë pune. Gjithashtu është një numër i konsiderueshëm personash me arsim të lartë (universitet) dhe arsim të mesëm që kanë profesione të ndryshme sikurse tregohet në figurën 10. Një pjesë e mirë e banorëve të arsimuar janë punësuar në sektorin publik.

Megjithatë, sikurse përmendet më sipër shkalla e papunësisë është mjaft e lartë. Sektori privat është kryesori për punësimin. Sikurse shihet nga figura 11, aktiviteti kryesor ekonomik është bujqësia dhe

Figura 11. Shpërndarja sipas Sektorëve të Punësimit të Banorëve të Vithkuqit

Lloji i aktivitetit	Sektori Privat		Sektori Publik		Gjithsej	
	Të punësuar	Gra	Të punësuar	Gra	Të punësuar	Gra
Bujqësi , gjueti silvikulturë	500	280	-		500	280
Tregtia, riparimi automob.dhe art. shtëpiak	10	2	-		10	2
Hotele dhe restorante	10	3	-		10	3
Transporti dhe telekomunikacioni	10		1		11	
Administrimi publik	-		37	4	37	4
Arsimi	-		23	13	23	13
Shëndeti dhe shërbimet sociale	1	1	11	7	12	8
Shërbime sociale kolektive dhe personale	25	3	-		25	3
Totali	555	289	72	24	627	313

blegtoaria. 500 persona, nga të cilat 280 gra janë të punësuar në këtë sektor.

Afërsisht 555 banorë, nga të cilat 289 gra janë punësuar në degë të tjera si transporti, shërbimet tregtare, bare dhe restorante, shëndetsia dhe shërbime të tjera duke përfshirë bujqësinë dhe blegtorinë.

Duke qenë se zhvillimi i ekonomisë lokale të Vithkuqit i jep prioritet disa fushave të zhvillimit ekonomik, është e justifikueshme që të kemi më shumë detaje.

b. Blegtoria

Ky sektor, sikurse shihet dhe nga tabela e mësipërme, është sektori ekonomik kryesor për komunën dhe numëron 500 të punësuar. Blegtoria është sektor tërheqës dhe vazhdimisht në rritje për komunën. Kushtet natyrore të komunës favorizojnë rritjen e deleve, dhive dhe gjedheve. Numri i krerëve në përgjithësi ka ardhur duke u rritur nëse i referohemi tabelës që bën një krahasim të vitit 2005 me atë të 2003. Ky zhvillim mund të shpjegohet me disa faktore si: kërkesa në rritje për produkte blegtorale, shtimi i sipërfaqeve me

foragjerë (ekzistenca e tokave për kullotë, që zënë 5500 ha në komunë), shpenzime jo të mëdha për zhvillimin e gjësë së gjallë, si dhe përshtatja e fermës së vogël për të rritur gjënë e gjallë. Figura 12 na jep një pamje të numrit të gjësë së gjallë në komunë.

Vitet	Të imta		Gjedhë	Shpendë
	Dele	Dhi		
2005	12100	2850	645	6070
2003	9600	1200	600	

Megjithëse prodhohet shumë mish, pikat e përpunimit të mishit në komunë mungojnë dhe kushtet në përgjithësi janë shumë të këqija. Ka vetëm dy pika për grumbullimin e qumështit, por këto pika nuk i plotësojnë nevojat e fermerëve në komunë, të cilët kanë përmendur si prioritet ndërtimin e një baxhoje të re dhe moderne në komunë. Një nga problemet kryesore të zhvillimit të blegtorisë mund të përmendim përmirësimin racor, përmirësimin e strukturës së të ushqyerit, krijimi i kushteve të përshtatshme higjieno-sanitare, dhe rritja e numrit të krerëve në çdo fermë. Figura 13 na jep një ide më të qartë për produktet dhe sasinë e tyre që prodhohet në komunë.

Delet			Dhitë		Lopët		Shpendët	
Mish	Qumësht	Lesh	Mish	Qumësht	Mish	Qumësht	Mish	Vezë
181	382	24.2	31.5	183	36.5	1295	-	477600


c. Bujqësia

Bujqësia dhe blegtoria përbëjnë sektorin kryesorë të punësimit në komunën e Vithkuqit. Bujqësia në komunën e Vithkuqit ashtu si në të gjithë vendin ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë periudhës së tranzicionit. Qarku karakterizohet nga ferma të vogla për sa i takon sipërfaqes së tokës (1.24 ha për rrethin e Korçës) dhe fragmentizim të brëndshëm të fermave në 4-8 pjesë. Kjo pengon në mënyrë të konsiderueshme produktivitetin e tyre. Gjatë reformimit, krahas me tokën u shpërndanë dhe asete të tjera si traktore, stalla etj. Toka bujqësore, me një sipërfaqe prej 2860 ha, është vendosur mbi një terren malor me pjerrësi mbi 25%. Struktura e tokës

Toke Bujqesore (ha)					
Ara (ha)	Pemishte (ha)	Vreshta (ha)	Pyje (ha)	Livadhe kullota (ha)	Te tjera (ha)
2693	163	2.7	8010	5500	5814

në komunën e Vithkuqit tregohet në figurën 14.

Prodhimet e dritherave





Ndryshimet në politikat e bujqesisë influencuan edhe prodhimin dhe orientimin e prodhimeve në komunë sikurse në gjithë qarkun e Korçës. Karakteristikë për këtë periudhë ishte mos prodhimi i disa produkteve që prodhoheshin shumë gjatë periudhës së komunizmit (gruri, thekra, dhe panxhar sheqeri), veçanërisht në zonat malore për shkak të cilësisë së tokës dhe lëvizjes së popullsisë. Prodhimet kryesore të komunës tregohen në figurën 15.

Figura 15. Prodhimet kryesore në Komunën e Vithkuqit						
Drithëra			Produkte bujqësore			Fruta (t)
Grurë (t)	Misër (t)	Thekër (t)	Të ndryshme (t)	Patate (t)	Fasule (t)	
285	266	45	2950	45	42	768

Zhvillimi aktual ekonomik i komunës përfshin disa drejtime e aspekte kryesore duke përmendur një hidrocentral lokal që prodhon energji për komunën, dy fabrika të prodhimit të birrës e të pijeve të tjera si edhe disa pika të vogla të rritjes së peshkut (troftë). Nxitja dhe përkrahja e këtyre bizneseve është përmendur edhe në Planin e Zhvillimit Lokal.

Pavarësisht nga gjithë këto mundësi për zhvillim, në qoftë se bëjmë fjalë për burimet natyrore dhe kapitalin Social, niveli i ulët i papunësisë i tejkalon avantazhet e këtyre aseteve. Opinioni i komunitetit e reflekton më së miri këtë problem. Kur janë pyetur për mundësitë e punësimit në komunë, 56.6 % e banorëve janë shprehur të pakënaqur.



d. Telekomunikacioni dhe Teknologjia Informuese

Në komunën e Vithkuqit është shumë i përhapur komunikimi me rrjetin e lëvizshëm telefonik prej kompanive AMC e Vodafone. Megjithatë banorët kanë nevojë për përdorimin e telefonisë fikse. Në panairët e ideve të organizuara në fshatra banorët e Vithkuqit përmendën një vizion të komunës me shërbim postar dhe telefonik të zhvilluar. Përsa i përket shërbimit postar në komunë ekziston vetëm një postë. Nuk mund të flasim për Teknologji informuese pasi në Vithkuq nuk ka asnjë linjë interneti apo kompjutera.

e. Turizmi

Komuna e Vithkuqit ka burime të shumëllojshme. Ka disa kisha, të shteti si monumente kulture, që nga shekulli i XII dhe paraqesin kulturor dhe historik. Banorët e ndërgjegjshëm për këto burime shfrytëzojnë disa për të gjeneruar komunë ndodhet një hotel dhe një disa kafe të vogla. Ka filluar të familjar, sidomos muajt e verës, duke e konsideruar frekuentuesit, si një vend klimatik të shkëlqyeshëm.




natyrore të pasura e cilat mbrohen nga kanë prejardhjen interes të madh Vithkuqit janë të dhe po përpiqen ti të ardhura. Në restorant, si dhe zhvillohet turizmi

3. MJEDISI DHE INFRASTRUKTURA

a. Pozita Gjeografike e Komunës

Komuna e Vithkuqit është njësi administrative e qarkut të Korçës. Ajo shtrihet në jug – perëndim të qytetit të Korçës, në një distancë prej 26 km (qytet – qendër e komunës).

Vendodhja e Komunes Vithkuq



Ka një sipërfaqe të përgjithshme 243,6 km² dhe është e ndarë në 13 fshatra: Vithkuq, Leshnjë, Gjanc, Roshanjë, Rehovë, Lubonjë, Shtyllë Cemicë, Panarit, Grabockë, Trebickë, Treskë, dhe Kat-Statober. Dendësia e

popullsisë është 12 banorë për km². Komuna ka 2,863 ha tokë të shpërndarë në 13 fshatra.

Figura 17. Shpërndarja e Tokës sipas Fshatrave

Vithkuq	Leshnjë	Gjanc	Rroshanj	Rehovë	Lubonjë	Shtylla	Çemerrica	Panariti	Grabocka	Trebickë	Treskë	Kat Statober
542	170	259	126	185	427	291	108	340	127	114	88	90

b. Burimet Natyrore

Komuna e Vithkuqit ka burime të pasura dhe të shumëllojshme natyrore. Ajo ofron një pejsazh të bukur kryesisht malor, me pyje të shumta e kullota masive, me ujra sipërfaqësore e nëntokësore të bollshme e cilësore, mes tyre edhe pesë laguna, me masive shkëmbore që i japin variacion në formë e në ngjyrë këtij pejsazhi. Vithkuqi ka sipërfaqe të konsiderueshme me pyje të llojeve të ndryshme e cila ka një bukuri natyrore mbreslënëse. Këto pyje sigurojnë lëndë drusore për djegie, ndërtim etj. ndërkohë ndikojnë në rritjen e shkallës së erozionit dhe probleme të tjera të ambientit. Në këto pyje rriten shumë bimë medicinale të cilat njerzëit po i shohin si burim fitimi. Pyjet e larta janë në gjendje relativisht më të mirë ndërsa korijet dhe pyjet shkurre janë dëmtuar seriozisht nga prerjet e pakontrolluara.

c. Sistemi Rrugor

Nga pikpamja administrative rrjeti rrugor ka dy pronarë: drejtoria e rrjetit rrugor rural dhe komuna.

Rrjeti rrugor dhe transporti është një nga instrumentat për zhvillim dhe duke qenë i tillë në vitet e fundit janë bërë investime të rëndësishme në rrjetin rrugor rural duke përdorur fondet e buxhetit të shtetit, donatorë të ndryshëm si dhe nga vetë komuna.




Figura 19. Rrjeti Rrugor në Vithkuq

Rrugë rurale rajonale (km)		Rrugë rurale komunale (km)		Rrugë Lagje (km)	
Asfalt.	Paasfalt.	Asfalt.	Paasfalt.	Asfalt.	Paasfalt.
5	17	-	34.5	-	6.5

Qendra e komunës lidhet me qytetin e Korçës nëpërmjet rrugës nacionale Korçë – Kolonjë dhe segmentit rrugor Ura e Floqit – Vithkuq. Me përjashtim të 2 km të paasfaltuar ende, pjesa tjetër e këtij segmenti është e asfaltuar. Me problematike mbetet rrjeti rrugor që lidh fshatrat e komunës. Rreth 34,5 km rrugë auto lidhin

fshatrat e komunës me qendrën e komunës dhe me rrugën nacionale. Ato janë të paasfaltuara. Rrugët brenda fshatrave janë të kalldrëmta por me cilësi që lenë për të dëshiruar.

Sipas anketimit të realizuar, banorët e komunës Vithkuq nuk janë të kënaqur me situatën aktuale të rrugëve në komunën e tyre.

d. Furnizimi me Energji Elektrike

Furnizimi me energji elektrike realizohet nga sistemi qendror i vendit, ka dy nënstacione dhe dy hidrocentrale lokale.

Figura 21. Rrjeti i Furnizimit me Energji Elektrike në Vithkuq

Rrjeti Kryesor TL (km)	Rrjeti kabllor I TU (km)	Numri i Kabinave Elektrike	Numri i Transformatorëve	Përfitues (familje)
48	49	16	16	880


e. Furnizimi me Ujë të Pijshëm

Figura 21. Rrjeti i Furnizimit me Ujë të Pijshëm		
Fshati	Gjatësia e rrjetit shpërndarës (km)	Gjatësia e rrjetit të jashtëm (km)
Vithkuq	3	2.5
Leshnjë	1	0.1
Gjanc	0.5	0.5
Rroshanj	0.5	5
Rehovë	0.6	1.5
Lubonja	2	5
Shtylla	1	1
Çemerrica	0.5	1
Panariti	2.5	3.5
Grabocka	0.5	1.5
Trebickë	-	-
Treskë	1	2
Kat-Statober		

Furnizimi me ujë të pijshëm të komunitetit, aktualisht përbën një prioritet për qeverisjen qendrore dhe atë vendore. Kjo shikohet jo vetëm në aspektin sasior por edhe atë cilësor dhe të dy lidhen drejtpërdrejt me përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë. Për furnizimin me ujë të pijshëm në komunë përdoren kryesisht dy mënyra: me ujesjellës dhe çezma sipërfaqësore. Furnizimi me ujë të pijshëm i popullsisë së komunës realizohet prej 14 ujesjellsash, 21.6 km linjë e jashtme dhe 13,1 km rrjet i brendshëm i fshatrave. Nga 773 familje që ka aktualisht komuna, 657 (85%) prej tyre furnizohen me ujë të pijshëm nga rrjeti. Pjesa tjetër përdor kryesisht çezmat publike apo burimet. Sikurse shihet dhe nga opinioni qytetar, 75% e popullsisë shprehen që janë të kënaqur me sasinë dhe cilësinë e ujit të pijshëm.

f. Kanalizimi i Ujrave të Zeza dhe të Bardha

Kanalizimi i ujrave të zeza dhe të bardha është një element i infrastrukturës që ka filluar të vlerësohet sidomos në vitet e fundit. Mënyra më e përhapur për sistemimin e ujrave të zeza në fshatra është ajo me gropa septike individuale, mosfunksionimi i të cilave shpesh sjell rrjedhjen e tyre duke shkaktuar probleme me mjedisin. Kanalizimi i ujrave të zeza është i pjesshëm. Rreth 2,6 km rrjet kryesor dhe 6,4 km rrjet sekondar u ofrojne shërbim jo të plotë 325 familjeve të fshatrave të komunës. Aktualisht kjo përbën dhe një problem për komunën. Sikurse shihet dhe nga opinioni qytetar i dalë nga anketimi i bërë në pranverë të 2005, 71% e popullsisë shprehen se janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me kanalizimet e ujrave të zeza.




4. QEVERISJA E KOMUNËS

a. Organika e Komunës Vithkuq

Në organikën e vet administrata e Komunës së Vithkuqit numëron 12 punonjës. Më poshtë janë të ilustruar dhe të ndarë sipas departamenteve:

Figura 25. Organika e Komunës së Vithkuqit



b. Buxheti i Komunës

Buxheti i komunës për vitin 2005 është 24,688,000 lekë,. Kjo sasi sikurse vihet re dhe në figurën 26 është shtuar shumë pak në tre vitet e fundit. Pjesa më e madhe e të ardhurave vjen nga fondi i kushtëzuar i qeverisë dhe buxheti i shtetit.

Figura 26. Burimet Kryesore në Buxhetin e Komunës (2003 – 2005)

Të ardhurat e komunës (në mijë lekë)					
Nr	Viti	Transferta (granit) nga Buxheti i shtetit	Fonde të kushtëzuara nga Qeveria (ministritë)	Të ardhurat e vetë Komunës	Total
1	2003	6800	12700	2500	22000
2	2004	7032	13405	2743	23180
3	2005	8438	13250	3000	24688

Kontributi i komunës në krijimin e të ardhurave mbetet i vogël dhe është 3,000,000 lekë, pra rreth 12,5 % e shumës totale të buxhetit. prej të cilit pjesën dërrmuese e kapin shpenzimet operative. Pjesa më e madhe e buxhetit shkon për shpenzimet operative dhe vetëm 1,700,000 lekë (6.88%) janë planifikuar

për investime kryesisht për shkollat, ujësjellësat dhe kanalizimet e ujrave të zeza.

Figura 27. Ku shkojnë të ardhurat (Shpenzimet e Komunës për vitin 2005)

Funksionet	Shpenzimet dhe të dalat (në mijë lekë)				
	Totali	Pagat	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	Shpenzime operative & mirëmbajtje	Investime
1.Administrata e përgjithshme	8230	3270	806	2754	1400
3.Arsimi	9499	6661	1738	800	300
4.Shëndetësia	3739	2097	742	900	
5.Kultura	389	267	61	61	
6.Çështje sociale	1104	1104			
7.Të tjera	223	194	29		
Nga këto:Fondi rezervë	240			240	
TOTALI	23424	13593	3376	4755	1700

Në vitet në vazhdim komuna synon të rris të ardhurat kryesisht nga tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël dhe nga disa tarifa shërbimi (zgjerim baze jo rritje niveli).

c. Pjesëmarrja Qytetare

Komuniteti i Vithkuqit është i interesuar që të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes në komunën e tyre. Rreth 44% e familjeve të intervistuar shprehën interesin e tyre në këtë çështje. Megjithatë pjesëmarrja vazhdon të ngelet e ulët: 77% e banoreve të intervistuar shprehën se nuk kanë marrë pjesë në asnjë aktivitet të organizuar në të mirë të zhvillimit të komunës. E njëjta gjë mund të thuhet për pjesëmarrjen në takime të hapura të komunës. Takimet në komunitet gjithashtu nuk tërheqin interesin e shumë banorëve; 55% e tyre shprehën se nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në këto takime dhe 79% shprehën se nuk kanë qenë vullnetar në asnjë aktivitet të organizuar në grup.

Këto të dhëna e kanë nxitur qeverisjen vendore të Vithkuqit që të përkushtohet në nxitjen dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së qytetarëve si një nga elementët e qeverisjes së mirë.

VIZIONI

Vithkuqi është një komunë që nën qeverisjen e mirë vendore ka një bujqësi dhe blegtori të zhvilluar, një infrastrukturë bashkëkohore dhe rrjet shërbimesh cilësore duke krijuar një mjedis komod jetese për komunitetin dhe një mjedis tërheqës për turistët në sajë të përdorimit efektiv të burimeve të veta njerëzore dhe natyrën e saj të bukur.

Zhvillimi Ekonomik

1. *Zhvillimi i Bujqësisë natyrore/biologjike*
2. *Zhvillimi i Blegtorisë*
3. *Zhvillimi i një Ekoturizmit cilësor*
4. *Përmirësimi i industrisë përpunuese ushqimore*
5. *Shtimi i mundësive për bizneset e vogla dhe të mesme nëpërmjet përdorimit të burimeve natyrore*

Infrastruktura/Shërbimet

1. *Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor*
2. *Hartimi i Planit rregullues*
3. *Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet e ujrave të zeza*
4. *Mbrojtja e mjedisit*
5. *Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit ujëtës dhe kullues*

Zhvillimi Social

1. *Përmirësimi i Kushteve higjeno-sanitare*
2. *Rritja dhe forcimi i sistemit arsimor*
3. *Rritja dhe forcimi i sistemit shëndetësor*
4. *Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike*
5. *Përmirësimi i jetës social kulturore të komunitetit*

Qeverisja e mirë

1. *Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit midis komunës, këshillit të komunës dhe kryepleqve*
2. *Rritja e transparencës*
3. *Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje*
4. *Përmirësimi i kapaciteteve për stafin*

Fusha Prioritare: Zhvillimi Ekonomik

Ekonomia e komunës sonë është mbështetur në zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë dhe ka ofruar më shumë mundësi dhe kushte më të përshtatshme fermerëve vendas në shtimin e bagëtive dhe prodhimtarisë dhe në të njëjtën kohë ngritjen e një infrastrukturë të përshtatshme për nxitjen e bizneseve ëe për përpunimin dhe tregtimin e këtyre prodhimeve.

Zhvillimi ekonomik i komunës ka sjellë rritjen e te ardhurave dhe përmirësimin e jetesës së banorëve të saj.

Objektivi Strategjik 1: Zhvillimi i Blegtorisë

Zhvillimi i blegtorisë synon rritjen e prodhimeve blegtorale nëpërmjet shtimit të krerëve dhe strukturës së bagëtive me 45% në vitin 2010 nga 15,600 krerë që numërohen sot dhe që mund të përballohen nga kapaciteti kullësor i kullotave natyrore dhe i sipërfaqes së tokës bujqësore që kultivohet me foragjerë. Pastrimi dhe përmirësimi racor me tendencë ruajtjen e llojit të vendit do të jetë subjekt i vazhdueshëm i kujdesit të specialistëve të fushës.

Objektivi Strategjik 2: Nxitja e biznesit të vogël & të mesëm

Komuna do të mbështesë individët, subjektet vendase apo të huaja të cilat planifikojnë të ngrejë biznese të përpunimit të produkteve blegtorale dhe bujqësore, robaqepsi, të zhvillojnë industrinë e përpunimit të bimëve medicinale, aromatike, dhe atyre industriale duke përdorur si krahë pune burimet njerëzore në komunë, si dhe mbështetjen e ndonjë iniciativë që synon shfrytëzimin e ujrave sipërfaqësore të rrjedhshme të komunës për prodhimin e energjisë elektrike duke ngritur një çentral të dytë në Vithkuq.

Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i Bujqësisë natyrore/biologjike

Tendenca e rritjes së sipërfaqes së mbjellë me frutikulturë dhe foragjere, klima e favorshme dhe përdorimi i sasive të vogla të pesticideve ka sjelle shtimin e produkteve biologjikisht të pastra. Kjo tendencë është kthyer në një objektiv të banorëve të komunës të cilët synojnë rritjen nga viti në vit të sipërfaqeve dhe rrënjëve me kulturat frutore duke shfrytëzuar kushtet e përshtatshme klimateriko-tokësore dhe eksperiencën e gjatë të fermerëve në këtë sektor. Shtimi i prodhimit të frutikulturës është shoqëruar me ambicjen për të përmirësuar infrastrukturën e magazinimit dhe të konservimit të produkteve.

Objektivi Strategjik 4: Zhvillimi i Ekoturizmit

Zhvillimi i ekoturizmit është mbështetur mbi përmirësimin e strukturave turistike ekzistuese duke investuar për përshtatje të ambjenteve për një zhvillim të qëndrueshëm. Nxitja e turizmit rural e agroturizmit, turizmit të gjuetisë, alpinizmit me grupe të vogla, me tenda, qendra fjetje në pika tërheqëse si në Shtyllë, Panarit, si dhe duke tentuar në afatgjatë në ngritjen e stacioneve dimërore komplekse me struktura të mëdha të shoqëruara me aktivitete promovionale nëpërmjet reklamave, panairëve dhe informimit.

FUSHA PRIORITARE: ZHVILLIMI EKONOMIK		STRATEGJI DHE PLANE KOMBËTARE DHE RAJONALE QË NDIKOJNË NË KËTË FUSHË PRIORITARE
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	1. Zhvillimi i Bujqësisë natyrore/ biologjike	1. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social
	2. Zhvillimi i Blegtorisë	2. Strategjia rajonale e Zhvillimit për Qarkun e Korçës
	3. Zhvillimi i Ekoturizmit	3. Objektivat e Zhvillimit për Mijëvjeçarin
	4. Nxitja e biznesit të vogël dhe të mesëm	
O.S	Projektet/plani i veprimit	Koha e realizimit
Zhvillimi i Blegtorisë		
1.	1. Rritja e numrit të krerëve dhe strukturës së bagëtive që mund të përballojë kapaciteti kullësor i kullotave natyrore dhe i sipërfaqes së tokës bujqësore që kultivohet me foragjerë (Bazë ushqimore për blegtorinë), duke synuar të arrijmë strukturën dhe numrin e bagëtive që përballon ky kapacitet kullësor	2005, në vazhdim
	2. Vaksinimi i përgjithshëm i kafshëve në të gjithë komunën.	2005, në vazhdim
	3. Ndërtimi i punës për pastrimin racor me tendencë që të ruajmë llojet e vendit.	2005, në vazhdim
	4. Përfshirja në organikën e komunës të personelit të kualifikuar veterinar dhe vendosja e një marrdhënie funksionale dhe të vazhdueshme me strukturat e specializuara në nivel qarku.	2006
	5. Inkurajimi nëpërmjet kreditimit të individëve të interesuar për ngritjen e një njësie për përpunimin e produkteve blektorale në fshatin Shtyllë.	2005, në vazhdim
	6. Studim për rritjen e peshkut troftë dhe shtimin e prodhimit të mjaltit duke nxitur aktivitetet ekzistuese.	2006
Zhvillimi i Bujqësisë natyrore		
2.	1. Shtimi i sipërfaqeve me pemët frutore nëpërmjet mbjelljeve të reja si mollë, kumbulla, qershi të llojeve të vendit.	2005, në vazhdim
	2. Studimi dhe organizimi i punës për sigurimin në vend të materialit mbjellës të pentarisë dhe bimeve të arave me qëllim që prodhimet të jenë natyrore.	2005 e në vazhdim
	3. Ndihmesë për fermerët me kredi për mekanizimin e punimeve në bujqësi në fshatrat Leshnjë, Vithkuq dhe Lubonjë.	2007
	4. Sistemi i tokës, mirëmbajtja e kanaleve kulluese dhe vaditëse në fshatit Leshnjë, Lubonjë dhe Makerza e Vithkuqit.	2006 - 2008
	5. Studimi dhe inkurajimi i ngritjes së një punishteje për përpunimin e frutave.	2005-2006
	6. Krijimi i marrdhënieve të qëndrueshme nëpërmjet Administratës së Komunës me Dhomën e Tregetisë, Drejtorinë e Bujqësisë dhe me bizneset e tregetimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore për të siguruar shitjen e prodhimeve.	2005 – në vazhdim
Zhvillimi i Ekoturizmit		
3.	3.1. Premirësimi i kushteve higjieno-sanitare në tërësi, ndërkohë që restorantet në Vithkuq kanë krijuar profilin e tyre me asortimentet e gatimit që janë tipike dhe karakteristike për zonën ton.	2005 e në vazhdim

	3.2. Përpilimi i një guide turistike për komunën tonë ku të evidentohen vlerat më të spikatura të kulturës, traditës dhe natyrës tonë të bukur dhe të pasur.	2007
	3.3. Ngritja e një këndi botanik ku të pasqyrohet pasuria e madhe bimore e zonës tonë.	2007
	3.4. Ndërtimi i një piste skish në Rrungaje të Vithkuqit, dhe krijimi i kushteve për zhvillimin e sportit të hipizmit në livadhet dhe pyjet e fshatit Shtyllë dhe Vithkuq.	2010 e në vazhdim
	3.5. Rregullimi dhe sistemimi i shtëpive si dhe largimi përfundimtar i bagëtive nga ambjentet e banimit.	2010
Nxitja e Biznesit të vogël dhe të mesëm		
4.	4.1. Studimi i tregut dhe inkurajimi i investitorëve privat për hapjen e një reparti për prodhimet artizanale të qëndisjes dhe rrobaqepsie në Vithkuq (Për një përdorim më të mirë të burimeve njerëzore nëpërmjet kontraktimit me subjektet private vendase dhe të huaja prodhues të konfeksioneve që operojnë me shumicë në qytetin e Korçës, si dhe identifikimi i tregjeve përkatëse të prodhimeve artizanale.	2006
	4.2. Mbështetja e bizneseve egzistuese të përpunimit të gurit dhe drurit duke ju krijuar kushte lehtësuese për zhvillimin dhe zgjerimin e tyre.	2008
	4.3. Identifikimi dhe mbështetja e nismave individuale ose të subjekteve për zhvillimin e biznesit për grumbullimin, manipulimin dhe tregëtimin e bimeve medicinale, aromatike dhe industriale si çaji i malit, dëllinja, tërfili, zhumbriça, luleshtogu, salep etj, me të cilat natyra e komunës tonë është e pasur.	2005, në vazhdim
	4.4. Identifikimi dhe mbështetja e nismave individuale ose të subjekteve për shfrytëzimin e ujrave sipërfaqësore të rrjedhëshme të komunës për prodhimin e energjisë elektrike duke ngritur një hidrocentral të dytë në Vithkuq.	2005, në vazhdim

O.S	INDIKATORËT SASIORË (OUTPUT)	AKTUALE 2005	I SYNUAR 2006	I SYNUAR 2008	I SYNUAR 2010
1.	Numri i bagëtive	15,595	18,000	20,000	22,600
	% e bagëtive të shëndetëshme	60%	70%	80%	90%
	Numri i njësive të përqëndrura për prodhimin e produkteve blektorale të përpunuara dhe në standarte bashkëkohore.	1	1	1	2
2.	Numri i fidanishteve dhe i parcelave për prodhimin e fidanëve dhe farave për dru frutorë	0	1	2	2
	Sipërfaqe të mbjella me dru frutorë				
	Numri i njësive të përqëndrura për prodhimin e produkteve të përpunuara frutore.	0	0	1	1
3	% e familjeve të gatshme për të zhvilluar turizmin familjar	20%	30%	50%	70%
	Numri i restoranteve me bazë kuzhinën tradicionale të zonës	1	2	4	6
	Numri i pikave turistike komplekse	0	1	2	3
4.	Numri i bizneseve të vogla dhe të mesme private të sektorit jo-bujqësor që operojnë në komunën Vithkuq	40	50	70	100
INDIKATORËT CILËSOR (OUTCOME)					
	% e banorëve të komunës të cilët e përshkruajnë cilësinë e jetës si shumë të mirë dhe të mirë	60%	70%	80%	90%
	% e banorëve të komunës të cilët janë të kënaqur me mundësinë për të filluar një biznes të ri	15.2%	20%	30%	50%
	% e banorëve të cilët janë të kënaqur me mundësinë për punësim	9.7%	10%	20%	35%
	% e familjeve të cilat sigurojnë të ardhura vjetore më të larta se 300,000 Lekë	9.7%	n/a	n/a	n/a
	% e banorëve të cilët janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me pastërtinë e komunës në përgjithësi	43.5%	50%	60%	70%

Objektivi 1: Zhvillimi i Blegtorisë		
<i>Zhvillimi i blegtorisë synon rritjen e prodhimeve blegtorale nëpërmjet shtimit të krerëve dhe strukturës së bagëtive me 45% në vitin 2010 nga 15,600 krerë që numërohen sot dhe që mund të përballohen nga kapaciteti kullësor i kullotave natyrore dhe i sipërfaqes së tokës bujqësore që kultivohet me foragjerë. Pastrimi dhe përmirësimi racor me tendencë ruajtjen e llojit të vendit do të jetë subjekt i vazhdueshëm i kujdesit të specialistëve të fushës.</i>		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënime	Deri ne vitin:
1.1 Rritja e numrit të krerëve dhe strukturës së bagëtive që mund të përballojë kapaciteti kullësor i kullotave natyrore dhe i sipërfaqes së tokës bujqësore që kultivohet me foragjerë (Bazë ushqimore për blegtorinë), duke synuar të arrijmë strukturën dhe numrin e bagëtive që përballon ky kapacitet kullësor	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Propagandimi i nismës për rritjen e numrit të bagëtive dhe produkteve blegtorale në Vithkuq ✚ Sigurimi me material racor për fshatrat duke kontaktuar dhe kërkuar mbështetjen e MBU, GTZ, SIDA, SBI, Fondi i Financimit Rural. 	2005, në vazhdim
1.2. Vaksinimi i përgjithshëm i kafshëve në të gjithë komunën.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Ngritja e një grupi të specializuar me veteriner nga komuna për gjurmimin e sëmundjeve infektive e të tjera. ✚ Identifikimi i fshatrave ku bagëtia është e prekur nga sëmundje të ndryshme dhe vënia në dijeni e agjensive/departamenteve përkatse që merren me vaksinimin ✚ Bashkëpunim i vazhdueshëm me programet financuese të MBU-së dhe Drejtoritë Rajonale të bujqësisë dhe ushqimit 	2005, në vazhdim
1.3. Ndërtimi i punës për pastrimin racor me tendencë që të ruajmë llojet e vendit.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Krijimi i një marrëveshje afatgjatë në bashkëpunim me Stacionin e Blegtorisë. ✚ Ndërgjegjësimi i komunitetit në lidhje me këto marrëveshje 	2005, në vazhdim
1.4. Përfshirja në organikën e komunës të personelit të kualifikuar veterinar dhe vendosja e një marrëdhënie funksionale dhe të vazhdueshme me strukturat e specializuara në nivel qarku.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Aprovimi i organikës së re për komunën ku të përfshihet departamenti për kujdesin ndaj bagëtive. ✚ Identifikimi në komunë i veterinerëve të kualifikuar 	2006
1.5. Inkurajimi nëpërmjet kreditimit ose financime private të individëve të interesuar për ngritjen e një njësie për përpunimin e produkteve blegtorale në fshatin Shtyllë.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Propagandimi mbi nevojën, mundësinë dhe mbështetjen për ndërtimin dhe funksionimin e një njësie për përpunimin e produkteve blegtorale në fshatin Shtyllë ✚ Komuna do të kontaktoj dhe të ndërhyj në agjenci kredituese siç janë MBU, 2KR, PSHB, Fondacioni i Financimit të Zonave Malore, Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA) si dhe Dhoma e Tregëtisë në Korçë 	2005, në vazhdim
1.6. Studim për rritjen e peshkut troftë dhe shtimin e prodhimit të mjaltit duke nxitur aktivitetet ekzistuese.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Krijimi i Shoqatave për Rritjen dhe Shtimin e Peshkut, Shoqata e Bletarëve. ✚ Ngritja e skemave pilot me vlerë të lartë në ujrat e freskëta të Vithkuqit ✚ Kontaktimi me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, DBU, Ministrinë e Mjedisit, Fondacionin e Financimit Rural, Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Rurale, etj.. 	2006

Objektivi 2: Zhvillimi i Bujqësisë natyrore/ biologjike		
<p><i>Tendenca e rritjes së sipërfaqes së mbjellë me frutikulturë dhe foragjerë, klima e favorshme dhe përdorimi i sasive të vogla të pesticideve ka sjellë shtimin e produkteve biologjikisht të pastra. Kjo tendecë është kthyer në një objektiv për banorët e komunës të cilët synojnë rritjen nga viti në vit të sipërfaqeve dhe rrënjeve me kulturat frutore duke shfrytëzuar kushtet e përshtatshme klimateriko-tokësore dhe eksperiencën e gjatë të fermerëve në këtë sektor. Shtimi i prodhimit të frutikulturës është shoqëruar me ambicjen për të përmirësuar infrastrukturën e magazinimit dhe të konservimit të produkteve.</i></p>		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
2.1. Shtimi i sipërfaqeve me pemët frutore nëpërmjet mbjelljeve të reja si mollë, kumbulla, qershi të llojeve të vendit.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Inkurajimi i fermerëve për shtimin e numrit të pemëve frutore ✚ Me financimet e MADAs do të ngrihet një fidanishte për prodhim fidanësh ndërkohë që ekzisotjnë 5 të tilla. ✚ Bashkëpunim me 2KR, ESHFF, IKB, PSHB, etj... 	2005, në vazhdim
2.2. Studimi dhe organizimi i punës për sigurimin në vend të materialit mbjellës të pemtarisë dhe bimëve të arave me qëllim që prodhimet të jenë natyrore.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Kontakte të vazhdueshme Institucione Shkencore si Stacioni i Kërkimeve Bujqësore në Korçë dhe Fakulteti i Bujqësisë në Universitetin e Korçës për prodhimin e farave me gjeneracion të lartë. ✚ Identifikimi i institucioneve të tjera apo individëve që merren me prodhimin e farnave. ✚ Nxitja e kompanive private që në bashkëpunim me fermerët pionerë në komunë të realizojnë hallkat e prodhimit të farnave duke përfshirë standartizimin, paketimin, ruajtjen dhe transportin e tyre në destinacion, etj... 	2005 e në vazhdim
2.3. Inkurajimi i investimeve private dhe ndihmëse për fermerët me kredi për mekanizimin e punimeve në bujqësi në fshatrat Leshnjë, Vithkuq dhe Lubonjë.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Aktivizimi i shoqatës së mekanizimit të fermerëve ✚ Kontaktimi me Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit për t'u orientuar lidhur me tipin e makinave dhe mjeteve të tjera bujqësore ✚ Kontakte të vazhdueshme me FFR, 2KR, FFZM, AZHZM për marrjen e kredive 	2007
2.4. Sistemimi i tokës, mirëmbajtja e kanaleve kulluese dhe vaditëse në fushat e fshatit Leshnjë, Lubonjë dhe Makerza e Vithkuqit.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Organizimi i Shoqatës së Fermerëve për Kullimin dhe Ujitjen ✚ Vazhdimi i Investimeve për rehabilitimin e rrjetit ujitës dhe kullues ✚ Bashkëpunim i vazhdueshëm me MBU, Bankën Botërore, Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Rurale, BIZH, etj. 	2006 - 2008
2.5. Studimi dhe inkurajimi i ngritjes së një punishteje për përpunimin e frutave.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Nxitja e bashkëpunimit me programin e projekteve kompetitive (PSHB) dhe 2KR; ✚ Identifikimi i alternativave të tjera për financimin e studimit 	2005-2006
2.6. Krijimi i marrdhënieve të qëndrueshme nëpërmjet Administratës së Komunës me Dhomën e Tregetisë, Drejtorinë Bujqësisë dhe me bizneset e tregëtimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore për të siguruar shitjen e prodhimeve.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Informimi i Fermerëve në komunë për strukturën e prodhimit, çmimet prezente në rajon, çmimet e pritshme etj... për të ndihmuar fermerët në vendimmarrje. Informacioni të shpërndahet në formë buletini. Një informacioni i tillë mund të merret në departamentet përkatëse të qarkut (Studimet që realizohen për tregun) ✚ Hedhja në tregun e shumicës në Korçë (tregu i ri) të produkteve ✚ Trajnime dhe asistencë teknike për përmirësimin e cilësisë së produkteve bujqësore, përmirësimin e paketimit, përdorimin e elementeve të përshtatshëm për reklamimin (reklama të përbashkëta, artikuj gazetash, panaire, etj), etj... 	2006 në vazhdim

Objektivi 3: Zhvillimi i ekoturizmit		
<i>Zhvillimi i ekoturizmit është mbështetur mbi përmirësimin e strukturave turistike ekzistuese duke invenstuar për përshtatje të ambjenteve për një zhvillim të qëndrueshëm. Nxitja e turizmit rural e agroturizmit, turizmit të gjuetisë, alpinizmit me grupe të vogla, me tenda, qendra fjetje në pika tërheqëse si në Shtyllë, Panarit, si dhe duke tentuar në terma afat-gjatë në ngritjen e stacioneve dimërore komplekse me struktura të mëdha të shoqëruara me aktivitete promovionale nëpërmjet reklamave, panairove dhe informimit.</i>		
Projektet/Hapat e Veprimt	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
3.1. Përmirësimi i kushteve higjeno-sanitare në tërësi, ndërkohë që restorantet në Vithkuq kanë krijuar profilin e tyre me asortimentet e gatimit që janë tipike dhe karakteristike për zonën tonë.	✚ Identifikimi i burimeve për kualifikime dhe lehtësimi i pjesëmarrjes në trainime për ata banorë që zotërojnë restorante apo që kanë ndërmend të fillojnë ose të përmirësojnë një biznes të tillë.	2005 e në vazhdim
3.2. Përpilimi i një guide turistike për komunën tonë ku të evidentohen vlerat më të spikatura të kulturës, traditës dhe natyrës tonë të bukur dhe të pasur.	✚ Explorimi i mundësive për financimin e bërjes së guidës (GTZ, Këshilli i Qarkut, etj...) ✚ Identifikimi i aktorëve të mundshëm për t'u përfshirë në hartimin e guidës (historian, fotograf, gjeograf, etj...)	2007
3.3. Ngritja e një këndi botanik ku të pasqyrohet pasuria e madhe bimore e zonës tonë.	✚ Identifikimi i hapësirës ku mund të krijohet këndi botanik ✚ Kontaktimi me Departamentin e Biologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës	2007
3.4. Ndërtimi i një piste skish në Rrungaje të Vithkuqit, dhe krijimi i kushteve për zhvillimin e sportit të hipizmit në livadhet dhe pyjet e fshatit Shtyllë dhe Vithkuq.	✚ Studimi i prefizibilitetit ✚ Kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut, donatorë të ndryshëm për mundësi financimi dhe investimi nga biznesi privat.	2010
3.5. Rregullimi dhe sistemimi i shtëpive si dhe largimi përfundimtar i bagëtive nga ambjentet e banimit.	✚ Studimi dhe zbatimi i një plani masiv për largimin e bagëtive nga banesat dhe grumbullimi e tyre në vende të përshtatshme për administrim higjeno-sanitar ✚ Kualifikimi masiv i banorëve të fshatrave me elementët bazë të turizmit familjar, të hotelerisë, restoranteve, etj... nëpërmjet shkollave, kurseve, trajnimeve, etj	2006, në vazhdim

Objektivi 4: Nxitja e Bizneseve të Vogla dhe të mesme		
<i>Zhvillimi i ekoturizmit është mbështetur mbi përmirësimin e strukturave turistike ekzistuese duke invenstuar për përshtatje të ambjenteve për një zhvillim të qëndrueshëm. Nxitja e turizmit rural e agroturizmit, turizmit të gjuetisë, alpinizmit me grupe të vogla, me tenda, qendra fjetje në pika tërheqëse si në Shtyllë, Panarit, si dhe duke tentuar në afat-gjatë në ngritjen e stacioneve dimërore komplekse me struktura të mëdha të shoqëruara me aktivitete promovionale nëpërmjet reklamave, panairove dhe informimit.</i>		
Projektet/Hapat e Veprimt	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
4.1. Identifikimi dhe mbështetja e nismave individuale ose të subjekteve për zhvillimin e biznesit për grumbullimin, manipulimin dhe tregëtimin e bimëve medicinale, aromatike dhe industriale si çaji i malit, dëllinja, tërfili, zhumbriça, luleshtogu, salep etj, me të cilat natyra e komunës tonë është e pasur.	✚ Propagandimi i burimeve natyrore dhe nxitja e interesit të individëve dhe subjekteve private; ✚ Lehtësimi i iniciativave private	2005, në vazhdim

<p>4.2. Identifikimi dhe mbështetja e nismave individuale ose te subjekteve për shfrytëzimin e ujrave sipërfaqore të rrjedhshme të komunës për prodhimin e energjisë elektrike duke ngritur një hidrocentral të dytë në Vithkuq.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e një hidrocentrali të ri në Vithkuq; ✚ Promovimi i të dhënave të studimit për ndërtimin e një hidrocentrali të ri në Vithkuq; 	<p>2007</p>
<p>4.3. Studimi i tregut dhe inkurajimi i investitorëve privat për hapjen e një reparti për prodhimet artizanale të qëndisjes dhe rrobaqepsië në Vithkuq (Për një përdorim më të mirë të burimeve njerëzore nëpërmjet kontraktimit me subjektet private vendase dhe të huaja prodhues të konfeksioneve që operojnë me shumicë në qytetin e Korçës, si dhe identifikimi i tregjeve përkatëse të prodhimeve artizanale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Studimi i prefizibilitetit për të parë mundësitë e realizimit ✚ Bashkëpunimi dhe kontaktim i vazhdueshëm me Dhomën e Tregtisë dhe Këshillin e Qarkut për të nxitur sipërmarrjen private në këtë drejtim. 	<p>2006</p>
<p>4.4. Mbështetja e bizneseve egzistuese të përpunimit të gurit dhe drurit duke ju krijuar kushte lehtësuese për zhvillimin dhe zgjerimin e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Bashkëpunim me FFR, AZHZM, etj., për të krijuar kushte dhe lehtësuar zhvillimin e këtyre bizneseve. 	<p>2008</p>

Fusha Prioritare: Infrastruktura/Shërbimet Publike

Përmirësimi i Infrastrukturës dhe bashkë me shërbimet publike janë realizuar kryesisht në drejtim të zgjerimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor, shtimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të ujit të pijshëm dhe kanalizimit të ujrave të zeza, të cilat sigurojnë edhe shërbimet publike bazë me ndikim të madh në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqënies. Është përmirësuar gjithashtu rrjeti i kanalizimeve për ujtje nëpërmjet rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së kanaleve vadiëse dhe atyre kulluese ekzistuese. Me fokus mbrojtjen e mjedisit i është kushtuar rëndësi e veçantë mbrojtjes së pyjeve si dhe mbrojtjes së tokës nga erozioni. Në të njëjten kohë është përgatitur një plan rregullues për komunën i cili ka orjentuar zhvillimin e infrastrukturës dhe lehtësuar rishikimin në kohë të Planit Lokal Të Zhvillimit. Prioritetet e dhënë dhe përmirësimet të shërbimeve të tjera publike siç janë telekomunikacioni, shërbimi i nastrimit forcimi i sinjalit televiziv etj



Objektivi Strategjik 1: *Përmirësimi i sistemit të ujit të pijshëm dhe kanalizimi i ujrave të zeza*

Duke qenë një komunë me potenciale për zhvillimin e turizmit një nga prioritetet e komunës së Vithkuqit është edhe përmirësimi i sistemit të ujit të pijshëm dhe i kanalizimeve të ujrave të zeza. Kjo është realizuar nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të ujësjellësave dhe kanalizimeve si dhe përmirësimit të atyre egzistues.

Objektivi Strategjik 2: *Përmirësimi dhe Mirëmbajtja e Rrjetit Rrugor*

Në zgjerimin, përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor prioritet është siguri i lidhjes funksionale me rrjetin rajonal dhe kombëtar nëpërmjet asfaltimit të segmentit rrugor Leshnjë-Vithkuq si dhe riparimi i rrugëve të fshatrave në drejtim të qendrës së komunës.

Objektivi Strategjik 3: *Planifikimi Hapsinor i Komunës Vithkuq*

Planifikimi i zhvillimit hapsinor të komunës është një objektivi afat-mesëm dhe synon hartimin e planeve rregullues për çdo fshat të komunës, caktimi i vendeve të depozotimit të mbeturinave familjare si dhe të plehurat organik në çdo fshat, si dhe azhurnimin e rrjetit inxhinierik (rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza, të ujësjellësit, elektrik) për çdo fshat të komunës, përfshirë këtu edhe përcakimin e zonave rekreative dhe industriale

Objektivi Strategjik 4: *Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit kullues dhe ujitës*

Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemeve kullues e ujitës është mbështetur kryesisht në rehabilitimin e kanaleve kryesore në fshatrat Leshnjë e Vithkuq, Lubonjë e Gjanc si dhe një zgjerim i rrjetit dytësorë në gjithë komunën

Objektivi Strategjik 5: *Përmirësimi i shërbimeve të tjera publike*

Përmirësimi i shërbimeve të tjera publike përfshin shtrirjen e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, largimin dhe pastrimin në tërësi, përmirësimin e shërbimit të telekomunikacionit dhe atij postar si dhe mbulimi i gjithë territorit të komunës me përsëritës televiziv për stacionet kombëtare televizive dhe krijimi i një sistemi transporti të rregullt.

Objektivi Strategjik 6: *Mbrojtja e mjedisit*

Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike ka në fokus mbrojtjen e mjedisit. Për këtë arsye vëmendje të veçantë i është kushtuar kryesisht mbrojtjes së pyjeve nga zjarret dhe prerjet e paligjshme si dhe mbrojtjen e burimeve të tjera natyrore si: burime ujore, bimët e kafshët e rralla.

Fusha Prioritare: Infrastruktura/ Shërbimet Publike		Strategjia, Plani Kombëtar dhe Rajonal që ndikojnë në këtë fushë prioritare	
Objektivat Strategjike	1. Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet e ujrave të zeza.		
	2. Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor.		
	3. Hartimi i planit rregullues.		
	4. Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit ujitës dhe kullues.		
	5. Përmirësimi i shërbimeve të tjera publike.		
	6. Mbrojtja e mjedisit.		
Hapat e Veprimit		Koha e Realizimit	Kosto e përafërt (në mijë Lekë)
Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet e ujrave të zeza			
1.	1.1 Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësave dhe përmirësimi i atyre egzistues (Ujësjellës i Ri në Gjanc dhe rikonstrukcioni i ujësjellësit të Lubonjës)	2007	6,000
	1.2 Kanalizimi i ujrave të zeza në fshatrat Vithkuq, Leshnjë dhe Lubonjë	2007	11,000
Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor.			
2.	2.1 Asfaltimi i segmentit rrugor Leshnjë-Vithkuq	2006	18,000
	2.2 Sistemimi i rrugëve brënda fshatit Vithkuq, Rehovë, Leshnjë dhe Lubonjë.	2007	14,000
	2.3 Riparimi i rrugëve të fshatrave nga qendra e komunës në çdo fshat, konkretisht në: Vithkuq-Shtyllë-Panarit, rruga kryesore-Rehovë, Pika e Bellovodës-Lubonjë (36 km)	2015	432,000
Hartimi i planit rregullues			
3.	3.1 Hartimi i planeve rregulluese për çdo fshat të komunës.	2006	6,000
	3.2 Azhurnimi i rrjetit inxhinierik (rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza, të ujësjellësit, elektrik) për çdo fshat të komunës	2006	n/a
	3.3 Caktimi i vendeve të depozitimit të mbeturinave familjare si dhe të plehut organik në çdo fshat të komunës.	2006	1,000
Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit ujitës dhe kullues			
4.	4.1 Veshja me pllaka betoni e kanaleve kryesore në fshatrat Leshnjë dhe Vithkuq.	2006	3,000
	4.2 Krijimi i kanaleve dytësore në gjithë komunën dhe rehabilitimi i kanaleve kryesore të sistemit kullues dhe ujitës në Leshnjë, Lubonjë, Vithkuq dhe Gjanc	2007	18,000
Përmirësimi i shërbimeve të tjera publike			
	5.2 Mbulimi i të gjithë territorit të komunës me përsëritës televizivë për stacionet televizive kombëtare.	2006	8,000
	5.3 Fuqizimi i antenave të operatorëve celulare në komunë me qëllim mbulimin e gjithë territorit	2006-2007	n/a

	5.4 Organizimi i shërbimit të pastrimit nëpërmjet grumbullimit, largimit, kompostimit dhe prodhimit të plehut organik prej tyre.	2006-2008	1,460
	5.5 Përmirësimi i shërbimit postar.	2007	n/a
	5.6 Instalimi i rrjetit të telefonisë fikse për çdo shtëpi në fshatrat e komunës.	2010	n/a
Mbrojtja e mjedisit			
6.	6.1 Mbrojtja e tokave nga erozioni	2006	7,000
	6.2 Mbrojtja e burimeve të tjera natyrore si: ujore, bimët dhe kafshët e rralla.	2006	5,000
	6.3 Mbrojtja e pyjeve nga prerjet e paligjshme dhe zjarret.	2009	6,000

Indikatorët Sasiorë	Aktuale 2005	I synuar 2006	I synuar 2008	I synuar 2010
1.Km e rrugëve të asfaltuara	5	7	10	22
2.Numri i fshatrave që u ofrohet shërbim i përmirësuar i rrugëve.	3	5	9	9
3.Numri i fshatrave me rrugë të rregulluara pjesërisht.	-	1	2	4
4.Numri i fshatrave të pajisur me plan rregullues, studime urbanistike	-	2	6	9
5.Numri i fshatrave të pajisur me rrjet inxhinierik	-	2	7	13
6.Numri i fshatrave që ju ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbeturinave.	-	2	9	13
7.Numri i ujësjellësave të rikonstruktuar.	-	1	2	3
8.Numri i familjeve përfituese nga rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza	350	380	420	483
9.Sasia e pyjëzimeve të reja.	-	3 HQ	5 HQ	8 HQ
10. Sistemimi i tokave bujqësore për rritje prodhimi	70 Ha	100 Ha	150 Ha	150 Ha
11.Përqindja e fshatrave të pasura me rrjet telefonik	-	-	50%	70%
12. Numri i fshatrave ku kryhet shërbimi postar.	1	2	8	13

Indikatorët Cilësor	Aktuale 2005	I synuar 2006	I synuar 2008	I synuar 2010
1.Përqindja e banorëve të pakënaqur nga gjendja aktuale e rrugëve në përgjithësi	45%	40%	30%	15%
2. Përqindja e banorëve të pakënaqur nga gjendja e rrugëve në fshatra të veçantë të komunës.	45%	30%	25%	10%
3. Përqindja e banorëve të kënaqur me furnizimin me ujë të pijshëm.	74%	74%	85%	94%
4.Përqindja e banorëve të pakënaqur nga rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza.	71%	65%	62%	56%

Objektivi 1: Përmirësimi i sistemi të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimit të ujrave të zeza		
<i>Duke qenë një komunë me potenciale për zhvillimin e turizmit një nga prioritet e komunës së Vithkuqit është edhe përmirësimi i sistemit të ujit të pijshëm dhe i kanalizimeve të ujrave të zeza. Kjo është realizuar nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të ujësjellësave dhe kanalizimeve si dhe përmirësimit të atyre egzistues.</i>		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
1. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësave dhe përmirësimi i atyre egzistues (Ujësjellës i ri në Gjanc dhe rikonstruksion në Lubonjë).	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjendjes dhe studimi i fizibilitetit ✚ Projekti teknik ✚ Përcaktimi i mekanizmit të finacimit - komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përfshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi investimesh. ✚ Prokurimi dhe ndërtimi 	2006 - 2007
2. Kanalizimi i ujrave të zeza në fshatrat Vithkuq, Leshnjë e Lubonjë.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjendjes dhe studimi i fizibilitetit ✚ Projekti teknik ✚ Përcaktimi i mekanizmit të finacimit - komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përfshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi investimesh. ✚ Prokurimi dhe ndërtimi 	2006 - 2007

Objektivi 2: Përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor		
<i>Në zgjerimin, përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor prioritet është sigurimi i lidhjes funksionale me rrjetin rajonal dhe kombëtar nëpërmjet asfaltimit të segmentit rrugor Leshnjë-Vithkuq si dhe riparimi i rrugëve të fshatrave në drejtim të qendrës së komunës.</i>		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin
1. Asfaltimi i segmentit rrugor Leshnjë-Vithkuq	✚ Ky projekt është përfshirë në listën e prioriteteve për investime dhe është miratuar nga Këshilli i Qarkut, FZSHH ka financuar një pjesë të këtij projekti	2006
2. Riparimi i rrugëve të fshatrave nga qendra e komunës në çdo fshat, konkretisht në : Vithkuq-Shtyll-Panarit, Rruga kryesore-Rehovë, Pika e Bellovodës-Lubonjë	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjendjes; përgatitja e studimeve të fizibiliteteve në përputhje me planin rregullues të komunës. ✚ Përcaktimi i mekanizmit të finacimit - komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përfshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi investimesh. 	2006, në vazhdim; synimi për përfundimin 2015

3. Sistemimi i rrugëve brënda fshatit në fshatin Vithkuq, Rehovë, Leshnjë dhe Lubonjë.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjendjes; përgatitja e studimeve të fizibiliteteve në përputhje me planin rregullues të komunës ✚ Përcaktimi i mekanizmit të financimit - komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përfshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi investimesh. 	2006, në vazhdim; synimi për përfundimin 2010
--	--	---

Objektivi 3 : Planifikimi Hapsinor i Komunës Vithkuq

Planifikimi i zhvillimit hapsinor të komunës është një objektivi afat-mesëm dhe synon hartimin e planeve rregullues për çdo fshat të komunës, caktimi i vendeve të depozotimit të mbeturinave familjare si dhe të plehut organik në çdo fshat, si dhe azhurnimin e rrjetit inxhinierik (rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza, të ujësjellësit, elektrik) për çdo fshat të komunës, përfshirë këtu edhe përcaktimin e zonave rekreative dhe industriale

Projektet/Hapat e Veprimt	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
1. Hartimi i planeve rregullues për çdo fshat të komunës	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjendjes dhe studimi i fizibilitetit për hartimin e planit rregullues hapsinor të komunës ✚ Hartimi i planeve rregulluese për fshatrat e komunës 	2006 2008
2. Azhurnimi i rrjetit inxhinierik (rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza, të ujësjellësit, elektrik) për çdo fshat të komunës.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Studimi i fizibilitetit për azhurnimin e rrjetit inxhinierik ✚ Hartimi i planimetrisë së rrjetit inxhinierik të komunës 	2006 2007
3. Caktimi i vendeve të depozotimit të mbeturinave familjare si dhe të plehut organik në çdo fshat.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Përcaktimi në hartimin e projektit rregullues të fshatrave të pikave të mbledhjes së plehrave ✚ Vendosija e tarifës së pastrimit ✚ Vlerësimi dhe përcaktimi i mënyrës së dhënies së shërbimit. 	2006 2007 2007

Objektivi 4: Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit kullues dhe ujitës

Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemeve kullues e ujtes do mbështet kryesisht në veshjen me pllaka betoni të kanaleve kryesore në fshatrat Leshnëe e Vithkuq si dhe në krijimin e kanaleve dytësore në gjithë komunën dhe rehabilitimi i kanaleve kryesore të sistemit kullues dhe ujitës në Leshnjë, Lubonjë, Vithkuq e Gjanc.

Projektet/Hapat e Veprimt	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
1. Krijimi i kanaleve dytësore në gjithë komunën dhe rehabilitimi i kanaleve kryesore të sistemit kullues dhe ujitës në Leshnjë, Lubonjë, Vithkuq e Gjanc.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjendjes ✚ Projekti teknik ✚ Përcaktimi i mekanizmit të financimit - komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përfshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi investimesh nga donatorë. ✚ Prokurimi dhe ndërtimi 	2006

2. Veshja me pllaka betoni e kanaleve kryesore në fshatrat Leshnjë e Vithkuq.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi i gjendjes ✚ Projekti teknik ✚ Përcaktimi i mekanizmit të financimit - komunikim i vazhdueshëm me komunitetin përfshirjen dhe kontributin e tyre në këto projekte, përfshirja e projekteve në buxhetin vendor, si dhe kontakte të vazhdueshme me Këshillin e Qarkut për mundësi investimesh. ✚ Prokurimi dhe ndërtimi 	2006
---	--	-------------

Objektivi 5: Përmirësimi i shërbimeve të tjera publike

Përmirësimi i shërbimeve të tjera publike përfshin shtrirjen e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, largimin dhe pastrimin në tërësi, përmirësimin e shërbimit të telekomunikacionit dhe atij postar si dhe mbulimi i gjithë territorit të komunës me përsëritës televiziv për stacionet kombëtare televizive dhe krijimi i një sistemi transporti të rregullt.

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
1. Organizimi i shërbimit të pastrimit nëpërmjet grumbullimit, largimit, kompostimit dhe prodhimit të plehut organik prej tyre.	✚ Organizimi i grupeve të rinjve nëpër fshatra për grumbullimin, largimin e plehrave në vende të përcaktuara më parë në hartimin e planit të infrastrukturës për kompostimin dhe prodhimin e plehut organik.	2006
2. Përmirësimi i shërbimit të telekomunikacionit dhe atij postar.	✚ Nëpërmjet takimeve të shpeshta komuna do të nxisë Telekomini që të përshpejtojë instalimin dhe përdorimin e sistemeve radiorele që në afat të mesëm të mbulohen të gjitha fshatrat në komunë.	2007
3. Mbulimi i gjithë territorit të komunës me përsëritës televiziv për stacionet kombëtare televizive.	✚ Nxitja dhe lehtësimi nëpërmjet takimeve periodike me përfaqësues të televizioneve kombëtare nga komuna apo sektori privat.	2006
4. Fuqizimi i antenave të operatorëve celular në komunë me qëllim mbulimin e gjithë territorit.	✚ Nxitja dhe lehtësimi përmes bisedimeve dhe të përkrahen operatorët privatë të zgjerojnë aktivitetin në komunë.	2006
5. Krijimi i një sistemi transporti të rregullt. (orare me të shpeshta)	✚ Kontaktimi me një agjenci private transporti nga komuna apo donatorë të ndryshëm për shtimin e numrit të mjeteve të transportit.	2006
6. Krijimi i pikave të riparimit të orendive elektro-shtepiake.	✚ Përkrahja e sektorit privat dhe krijimi i lehtësive për kontaktimin nga ana e tyre me kredithënës si dhe mbështetja në gjejtjen e tregut nga komuna.	2006
7. Mirëmbajtja e çezmave publike.	✚ Përcaktimi i një fondi në buxhetin e komunës si dhe nxitja e sektorit privat vendas për mirëmbajtjen e çezmave publike.	2007

Objektivi 6: Mbrojtja e mjedisit


Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike ka në fokus mbrojtjen e mjedisit. Për këtë arsye vëmendje e veçantë është kushtuar kryesisht në mbrojtjen e pyjeve nga zjarret dhe prerjet e paligjshme si dhe në mbrojtjen e burimeve të tjera natyrore si: burime ujore, bimët e kafshët e rralla..

Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
-----------------------------------	------------------------------	-----------------------

1. Mbrojtja e pyjeve nga zjarret dhe prerjet e paligjshme.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Futja në organikën e komunës të personelit të ruajtjes së pyjeve ✚ Ndërgjegjësimi i komunitetit për rëndësinë e pyjeve nëpërmjet formave të trajnimit. 	2007
2. Mbrojtja e tokave nga erozioni	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Mbjellja e pemëve pranë lumenjve, barriera pranë shtratit të lumenjve, si dhe parandalimi i gryrjeve të paligjshme të tyre. 	2007
3. Mbrojtja e burimeve të tjera natyrore si: burime ujore, bimë e kafshe të rralla.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Përcaktime të sanksioneve/gjobave të ndryshme për shpërdorimin apo gjuetinë e paligjshme. Këto sanksione caktohen në bashkëpunim me ekspertë dhe miratohen nga Këshilli i komunës. ✚ Propozime të vazhdueshme për ndryshime të ligjeve që përcaktojnë mbrojtjen e këtyre burimeve natyrore. 	2006

Fusha Prioritare: Zhvillimi Social

Zhvillimi Social është përqëndruar kryesisht në drejtim të përmirësimit të jetës social kulturore, dhe të kushteve higjeno-sanitare. Qendra e re kulturore i ka dhënë një nxitje të fortë gjallërimit të jetës kulturore dhe sociale në komunë, Banorët janë ndërgjegjësuar për rëndësinë dhe kujdesin që duhet t'i jepet ruajtjes së standarteve të larta higjeno-sanitare. Qendrat shëndetsore ofrojnë shërbime të përmirësuara mjeksore duke përfshirë ilaçe dhe pajisje të domosdoshme. Në zonat e largëta nga shkollat nxënësve janë krijuar kushte lehtësuese për arsimin e tyre si p.sh transporti, i cili ka sjellë rritjen e numrit të nxënësve të shkollave. Një element i rëndësishëm në zhvillimin social është ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike të komunës.



FUSHA PRIORITARE: Zhvillimi Social		STRATEGJI DHE PLANE KOMBËTARE APO RAJONALE QË NDIKOJNË NË KËTË FUSHË PRIORITARE
Objektivat Strategjike	1. Përmirësimi i jetës social kulturore të komunitetit	
	2. Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike	
	3. Rritja dhe forcimi i sistemit shëndetsor	
	4. Rritja dhe forcimi i sistemit arsimor	
	5. Përmirësimi i kushteve higjieno sanitare	
Hapat e Veprimit		Koha e Realizimit
Permireshimi i jetes social kulturore te komunitetit		
1.	1.1 Ngritja e qendrës kulturore në Vithkuq	2008
	1.2 Organizimi i funksionimit dhe pajisja e grupeve artistike me mjetet e nevojshme	2006 në vazhdimësi
	1.3 Organizimi i aktiviteteve kulturore në komunë	2007
	1.4 Ngritja e ambjenteve çlodhëse dhe argëtuese për fëmijët dhe pleqtë	2010
Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike		
2.	2.1 Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e këtyre veprave kulturore	Në vazhdimësi
	2.2 Promovimi i veprave kulturore dhe traditave brënda dhe jashtë vendit.	2009
	2.3 Rikonstruksioni i veprave kulturore historike në çdo fshat të komunës (kishat) dhe ruajtja e këtyre veprave	2015
Rritja dhe forcimi i sistemit shëndetësor		
3.	3.1 Ngritja tekniko profesionale e personelit mjekësor nëpërmjet trajnimeve/specializimeve afatshkurtër	Në vazhdimësi
	3.2 Forcimi i masave për parandalimin e sëmundjeve infektive nëpërmjet procesit të imunizimit	Në vazhdimësi
	3.3 Furnizimi i ambulancave me pajisjet e domosdoshme të emergjencës si dhe medikamentet dhe materialet e mjekimit	Në vazhdimësi
	3.4 Ngritja e objekteve shëndetësore në fshatrat ku mungojnë	2008
Rritja dhe forcimi i sistemit arsimor		
4.	4.1 Futja e lëndës së gjuhës së huaj në shkollën e mesme&8-vjeçare	2006
	4.2 Sigurimi i transportit të nxënësve për në shkolla.	2006
	4.3 Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies	2005, në vazhdim
	4.4 Ngritja / rikonstruksioni i institucioneve arsimore shkollore dhe parashkollore	2007 – në vazhdim
	4.5 Ngritja e laboratorëve për shkencat natyrore në shkollën Vithkuq dhe Lubonjë	2010
Përmirësimi i kushteve higjieno sanitare		
5.	5.1 Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kulturës higjieno sanitare në fshatra	Vazhdimisht

5.2 Grumbullimi dhe sistemimi i mbeturinave për gjithë fshatrat	2006-2009
5.3 Rritja e nivelit higjieno sanitar në institucionet lokale (shkolla, qendra shëndetësore, kopshte, zyrat e administratës)	2007
5.4 Largimi përfundimtar i bagetive nga ambientet e banimit	2010

Indikatorët Sasior	Aktuale 2005	Synuar 2006	Synuar 2008	Synuar 2010
Numri i qendrave social kulturore	0	1	1	1
Numri i ambulancave të ndërtuara rishtazi	0	1	2	2
Numri i qendrave shëndetësore të ndërtuara rishtazi	0	0	0	1
Numri i shkollave të rikonstruara	0	1	2	2
Numri i kopshteve të ndërtuara rishtazi për fëmijë	0	0	1	1
Paisja e shkollave me laboratorë profesionale	0	1	3	4

Indikatorët Cilësorë	Aktuale 2005	Synuar 2006	Synuar 2008	Synuar 2010
% e banorëve shumë të kënaqur dhe të kënaqur me shërbimin e kopeshteve dhe të çerdheve për fëmijë	28.4 %	30%	50%	50 %
% e banorëve shumë të kënaqur dhe të kënaqur me gjendjen e shkollave në komun	63.4 %	70%	75%	80%
% e banorëve shumë të kënaqur dhe të kënaqur me jeten kulturore dhe artisitike në komunë	13.8 %	30%	45%	60%
% e banorëve shumë të kënaqur dhe të kënaqur me shërbimin shëndetësor	41.8%	50%	55%	60%

Objektivi 1: Përmirësimi i jetës social kulturore të komunitetit			
Përmirësimi i jetës sociale ka sjellë uljen e migrimit të të rinjve nga komuna drejt qyteteve apo jashtë vendit. Pjesëeë përmirësimit të jetës social kulturore është bërë ngritja e qendrës kulturore në fshatin Vithkuq, ngritja e ambjenteve çlodhëse dhe argëtuese për fëmijët dhe pleqtë si dhe organizimi i grupeve artistike dhe i aktiviteteve kulturore.			
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:	Kosto e Përafërt (mijë Lekë):
1. Ngritja e qendrës kulturore në Vithkuq	<ul style="list-style-type: none"> ✚Projektimi ✚Mbledhja e kontributit ✚Ndërtimi 	2008	14,000
2. Organizimi, funksionimi, paisja e grupeve artistike, organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike	<ul style="list-style-type: none"> ✚Organizimi i këshillit të kulturës ✚Identifikimi i aftësive dhe individëve artistikë tradicional ✚Formimi i grupeve artistike ✚Formulimi i programit të aktiviteteve dhe aprovimi në Këshillin e komunës 	2006 e në vazhdim	1,000
3. Ngritja e ambjenteve çlodhëse dhe argëtuese për fëmijët dhe pleqtë	<ul style="list-style-type: none"> ✚Ndërtimi i një këndi lojrash për fëmijët ✚Ngritja e lulishteve me stola dhe ambjente çlodhese 	2010 2010	1,500 1,200

Objektivi 2: Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike		
Komuna Vithkuqi përmendet për pasurinë e saj me vlera kulturore dhe historike. Rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e veprave dhe objekteve kulturore e historike në çdo fshat të komunës (kishat) dhe ruajtja e këtyre veprave është një nga objektivat kryesore në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe traditave brënda dhe jashtë vendit.		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
1. Rikonstruksioni i veprave kulturore historike në çdo fshat të komunës (kishat) dhe ruajtja e këtyre veprave	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Kontakti dhe zhvillimi i një plani të përbashkët me Institutin e Monumenteve të Kulturës ✚ Planifikimi dhe bashkëfinancimi i rikonstruksionit të Manastirëve të Shën Pjetrit, Kishës së Shën Mhillit, Lubonjës dhe Katundit 	2015
2. Promovimi i veprave kulturore dhe traditave brënda dhe jashtë vendit.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Hartimi i guidës turistike dhe të promovimit të vlerave kulturore historike të Komunës 	2008
	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Realizimi i një spoti televiziv dhe fushata e ndërgjegjësimit dhe informimit kombëtar nëpërmjet medias 	2008
3. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e këtyre veprave kulturore	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Promovimi i vlerave kulturore dhe historike të komuniteti 	2005, në vazhdim

Objektivi 3: Rritja dhe forcimi i sistemit shëndetësor		
Rritja dhe forcimi i shërbimit shëndetësor është shoqëruar me përmirësimin e infrastrukturës, ngritjen e objekteve shëndetësore dhe ambulancave të pajisura në fshatrat ku mungonin, duke mos lënë mënjanë dhe forcimin e masave për parandalimin e sëmundjeve infektive nëpërmjet imunizimit. Për të realizuar një shërbim të mirë dhe të kualifikuar është konsideruar primare ngritja tekniko profesionale e personelit mjekësor nëpërmjet trajnimeve dhe specializimeve afatshkurtër.		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
1. Ngritja e objekteve shëndetësore në fshatrat ku mungojnë	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Rishikimi dhe rivlerësimi i nevojave për rikonstruksion apo ndërtesa të reja shëndetësore. ✚ Studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi i kostos për ndërtimin, rikonstruksionin dhe pajisjen e objekteve shëndetësore ✚ Duke filluar nga viti 2007 përfshirja në buxhetin e komunës të rikonstruksionit të objekteve ekzistuese si dhe përfshirja e objekteve të reja shëndetësore për ndërtim. ✚ Identifikimi i burimeve të tjera të financimit për bashkëfinancimin e ndërtimit, rikonstruksionit dhe pajisjes së objekteve shëndetësore 	2010


2.Ngritja tekniko profesionale e personelit mjekësor nëpërmjet trajnimeve/specializimeve afatshkurtër	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Identifikimi dhe punësimi i personelit profesional dhe sigurimi i trajnimit të vazhdueshëm ✚ Lidhja me institucionet shëndetësore shkencore në nivel qarku, eksplorimi i mundësive për trainim dhe ofrimi i literaturës bashkëkohore 	2006 dhe në vazhdimësi
3. Forcimi i masave për parandalimin e sëmundjeve infektive	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Debistimi i sëmundshmërisë dhe studimi ✚ Rritja e kulturës shëndetësore nëpërmjet ndërgjegjësimit të komunitetit ✚ Vaksinimi i rregullt i popullsisë 	2005 e në vazhdimësi
4. Furnizimi i ambulancave me pajisjet e domosdoshme të emergjencës si dhe medikamentet dhe materialet e mjekimit	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Identifikimi i nevojave për pajisjet e domosdoshme të emergjencës dhe medikamente ✚ Krijimi i lehtësirave nga ana e komunës për ngritjen e një farmacie private në komunë 	2006 dhe në vazhdim

Objektivi 4: Rritja dhe forcimi i sistemit arsimor		
Objektet arsimore janë përmirësuar dhe lehtësuar dhe rritur numrin e nxënësve në shkolla. Forcimi i dijës është përputhur me profilin e komunës, janë ngritur laboratorët për shkencat natyrore në shkollat Vithkuq dhe Lubonjë, si dhe është bërë i detyrueshëm programi i gjuhës së huaj në shkollën e mesme dhe 8 vjeçare duke qenë se komuna është me perspektivë në zhvillimin e turizmit dhe thithjen e vizitorëve nga vendi dhe të huaj. Transporti i përmirësuar siguron shkollimin e nxënësve nga zonat e largëta duke ulur ndjeshëm numrin e fëmijëve që braktisin shkollën.		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
1. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Trajnimi/kualifikimi i arsimtarëve ✚ Vendosja e kriterëve dhe punësimi i mësuesve sipas profilit dhe arsimimit ✚ Forcimi i lidhjeve të komitetit të prindërve me mësuesit 	2006 dhe në vazhdim
2. Futja e lëndës së gjuhës së huaj në shkollën e mesme & 8-vjeçare	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Krijimi i mundësive nëpërmjet drejtorisë arsimore për përfshirjen e mësuesve të gjuhës së huaj ✚ Futja e gjuhës së huaj edhe në aktivitetet jashtë shkollore ✚ Tërheqja e vullnetarëve të Korpusit të paqes për të asistuar në zhvillimin e lëndës së gjuhës së huaj 	2006
3. Sigurimi i transportit të nxënësve për në shkolla.	✚ Kontraktimi i subjekteve private nga komuna për manaxhimin e transportit të nxënësve, duke inkurajuar financimin e pjeshëm nga familjet.	2006-2007
4.Ngritja / rikonstruksioni i institucioneve arsimore shkollore dhe parashkollore.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Rikonstruksioni i objekteve shkollore Panarit dhe Shtyll-Rehovë ✚ Vlerësimi, studimi i fizibilitetit dhe përfshirja në buxhetin e komunës për financim të drejtpërdrejtë dhe bashkëfinancim të rikonstruksionit të objekteve ekzistuese si dhe e objekteve të reja përfshirë kopshtin e fëmijëve Vithkuq. 	2007-2010
5.Ngritja e laboratorëve për shkencat natyrore në shkollën Vithkuq dhe Lubonjë	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Vlerësimi, studimi i fizibilitetit, planifikimi dhe caktimi i hapësirave të mundshme për ngritjen e laboratoreve në disa prej shkollave të komunës. ✚ Kontaktimi me Ministrinë e Arsimit, Drejtorinë Arsimore apo donatorë të ndryshëm për mundësi financimi të ndërtimit dhe paisjes së laboratorëve shkollore. 	2010

Objektivi 5: Përmirësimi i kushteve higjieno sanitare		
<p>Banorët janë ndërgjegjsuar dhe inkurajuar për rëndësinë dhe kujdesin që duhet t'i jepet ruajtjes së standarteve të larta higjieno-sanitare nëpër familje si dhe nëpër institucione (shkolla, qendra shëndetësore, kopshte, zyrat e administratës) dhe ambientet e shërbimit. Identifikimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit të ujrave të zeza dhe të bardha ka sjellë rritjen e standarteve të kushteve higjieno-sanitare. Gjithashtu është arritur ndërtimi i ujësjellësave dhe shtrirja e tubacioneve që për pasojë ka sjelle dhe sigurimin e ujit të pijshëm brenda shtëpive në ato fshatra ku nuk ekzistonte. Grumbullimi dhe sistemimi i mbeturinave për gjithë fshatrat është përmirësuar ndërsa bagetitetë janë larguar nga ambientet e banimit.</p>		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
1. Ngritja e kulturës higjieno sanitare në fshatra	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Ndërgjegjësimi i banorëve për rreziqet që shkakton mungesa e kujdesit për higjenën me anë të fletëpalosjeve, postera, mbledhjeve të hapura me komunitetin të drejtuar nga personel shëndetësor dhe angazhimi i organizmave jo qeveritare të specializuara. 	<i>Nga 2005 dhe në vazhdim</i>
2. Grumbullimi dhe sistemimi i mbeturinave për gjithë fshatrat	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Caktimi i Pikave të grumbullimit ✚ Ndërgjegjësimi i komunitetit për t'i hedhur mbeturinat në vendet e caktuara ✚ Aktivizimi i të rinjve të fshatit për grumbullimin e mbeturinave ✚ Tërheqja në mënyrë periodike e mbeturinave duke nënkontraktuar subjekte private 	<i>2006 dhe në vazhdim</i>
3. Rritja e nivelit higjieno sanitar në institucionet lokale (shkolla, qendra shëndetësore, kopshte, zyrat e administratës)	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Përpilimi i një rregullore të brendshme për higjenën në institucione ✚ Ndërgjegjësimi i personelit dhe banorëve në institucione për higjenën nëpërmjet fletëpalosjeve, seminareve, etj., dhe ushtrimi i kontrollit e sanksioneve. 	<i>2006 dhe në vazhdim</i>

Fusha Prioritare: QEVERISJA E MIRE

Qeverisja e mirë në komunën Vithkuq është bërë promotore e zhvillimit ekonomik dhe social. Strukturat vendim-marrëse dhe ekzekutive të komunës janë të hapura për një vendim-marrje me pjesëmarrje të gjerë të komunitetit. Zbatimi i vendimeve është mbështetur në parimin e decentralizimit dhe përcaktimit rigoroz të përgjegjësive. Banorët e komunës gjejnë informacionin e nevojshëm, ndërsa iniciativat për biznes janë mbështetur dhe lehtësuar nga administrata dhe vendim-marrësit. Mbledhjet e hapura të këshillit, anketimet, publikimi i informacionit janë bërë mjete komunikimi gjerësisht të përdorshme ndërmjet komunës dhe banorëve të saj. Personeli administrativ është i qëndrueshëm dhe me kapacitete në rritje në përgjigje të dinamikës së zhvillimit dhe të nevojave të komunitetit.



Objektivi Strategjik1: Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit midis komunës, këshillit të komunës dhe kryetarëve të fshatrave

Një nga elementet e mirë-qeverisjes ka qenë gjithmonë decentralizimi i vendim-marrjes dhe ekzekutimit, përcaktimi dhe ndarja e përgjegjësive të organeve apo individëve të ndryshëm brenda strukturave të qeverisjes vendore përmes hartimit dhe përdorimit të një kodi etike për komunën ku përfshihen dhe detajohen marrdhëniet komunë- këshilli – kryepleqësi. Kjo është shoqëruar dhe me realizimin e takimeve/tavolinave të hapura për kryetarët e fshatrave dhe banorët e komunës me qëllim informimin, vlerësimin e nevojave dhe priorizimin e veprimeve dhe investimet e realizuara apo ato të planifikuara.



Objektivi Strategjik2: Rritja e transparencës

Transparenca me komunitetin është parim themelor i aktivitetit vendim-marrës dhe ekzekutiv të komunës e cila ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për marrjen dhe dhënien e informacionit nëpërmjet publikimit në stenda apo nëpërmjet fletëpalosjeve lidhur me ndyshimet në strukturën e komunës, buxhetin, taksat dhe tarifën, investimet e bëra dhe ato të planifikuara, etj. Një person në administratën e komunës është ngarkuar posaçërisht për shpërndarjen e informacionit.

Objektivi Strategjik 3: Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendim-marrje

Rritja e transparencës dhe komunikimit është zhvilluar njëkohësisht edhe në kahun e marrjes së informacionit nga komuniteti. Marrja e mendimit nga komuniteti nëpërmjet takimeve të hapura në fshatra të kombinuara me anketimin masiv janë bërë mjete të përdorimit të zakonshëm për indentifikimin e nevojave dhe të prioriteve në kuadrin e hartimit të buxhetit si dhe rishikimin e planeve afat-gjata të zhvillimit.

Objektivi Strategjik 4: Përmirësimi i kapaciteteve për stafin dhe këshilltarët

Përmirësimi i komunikimit me të gjitha nivelet, rritja e transparencës, thithja e opinionit qytetar kanë kërkuar një staf dhe këshill komune të përgatitur si dhe mjete të nevojshme për t'u realizuar. Për këtë qëllim, trajnimi i vazhdueshëm i administratës për funksionet që mbulon, trajnimi i këshilltarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, rolin dhe marrdhëniet me administratën si dhe aftësi komunikuese kanë qenë elementët kryesor për ngritjen e kapaciteteve. Funksionimi dhe kompletimi i arshivës me bazën e nevojshme materiale si dhe paisja e domosdoshme e komunës me kompjutera janë bërë elementët në aktivitetin a vazhdueshëm të komunës.

FUSHA PRIORITARE: Për një qeverisje më të mirë		STRATEGJI DHE PLANE KOMBËTARE APO RAJONALE QË NDIKOJNË NË KËTË FUSHË PRIORITARE
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	1. <i>Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit midis komunës, këshillit të komunës dhe kryepleqve</i>	
	2. <i>Rritja e transparencës</i>	
	3. <i>Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje</i>	
	4. <i>Përmirësimi i kapaciteteve për stafin dhe këshilltarët</i>	
Hapat e veprimit		Koha e realizimit
<i>Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit midis komunës, këshillit të komunës dhe kryepleqve</i>		
1.	1.1 Përgatitja, aprovimi dhe vënia në përdorim i një kodi etike për komunën ku përfshihen dhe detajohen marrdhëniet komunë- këshill – kryepleqësi si dhe konsolidohet pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje.	2006, në vazhdim
	1.2 Realizimi periodik i takimeve/tavolinave të rrumbullakta me qëllim informimin e kryetarëve të fshatrave, këshillit të komunës dhe kryetarit për punën e kryer, investimet e realizuara, ato të planifikuara apo aktivitete të ndryshme.	2006, në vazhdim
	1.3 Realizimi i takimeve/tavolinave të rrumbullakta me qëllim marrjen e informacionit nga kryepleqtë për nevojat e fshatrave.	2006, në vazhdim
	1.4 Thirrja e kryetarëve të fshatrave dhe banorëve të spikatur në mbledhjet e këshillit të komunës dhe realizimi i seancave dëgjimore paraprirëse të mbledhjeve të këshillit me qëllim vendim-marrje të rëndësishme.	2006, në vazhdim
<i>Rritja e transparencës</i>		
2.	2.1 Ngritja e standës së informacionit në komunë	2006, në vazhdim
	2.2 Caktimi i një personi në stafin e komunës për të ofruar informacion tek komuniteti në zyrat e komunës.	2006, në vazhdim
	2.3 Afishimi i informacionit të nevojshëm (struktura e komunës, buxheti, taksat dhe tarifat, investimet e bëra dhe ato të planifikuara, etj..) në stendën e komunës.	2006, në vazhdim
	2.4 Organizimi i mbledhjeve të hapura/seancave dëgjimore për komunitetin gjatë miratimit të proceseve/aktiviteteve të rëndësishme që ndikojnë jetën e komunitetit.	2006, në vazhdim
	2.5 Nxitja e marrdhënieve me median lokale/kombëtare, të shkruar dhe vizive.	2006, në vazhdim
<i>Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje</i>		
3.	3.1 Marrja e mendimit qytetar dhe e komunitetit nëpërmjet takimeve të hapura në fshatra me pjesëmarrjen e kryetarëve të fshatrave, kryetarit të komunës dhe antarëve të këshillit	2006, në vazhdim
	3.2 Përdorimi i mjeteve të ndryshme për të marrë opinionin e qytetarëve gjatë hartimit të buxhetit dhe caktimit të prioriteteve.	2006, në vazhdim
	3.3 Organizimi i mbledhjeve të hapura, anketimeve për marrjen e vendimeve të rëndësishme që ndikojnë në jetën e komunitetit	2006, në vazhdim

	3.4 Përgatitja e herëpashershme e fletëpalosjeve për informimin e komunitetit.	2006, në vazhdim
Përmirësimi i kapaciteteve për stafin dhe këshilltarët		
4.	4.1 Përgatitja dhe aprovimi i një rregullore të brendëshme për funksionimin e ekzekutivit dhe ndarjen e përgjegjësive në mënyrë që të rritet efica dha efektiviteti i zyrtarëve të administratës	2007, në vazhdim
	4.2 Trajnimi i vazhdueshëm i administratës për funksionet që mbulon	2006, në vazhdim
	4.3 Trajnimi i këshilltarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, rolin dhe marrdhëniet me administratën si dhe aftësi komunikuese.	2006, në vazhdim
	4.4 Paisja e domosdoshme e komunës me kompjutera.	2007, në vazhdim

Indikatorët Cilësor	Aktuale 2005	I synuar 2006	I synuar 2008	I synuar 2010
1. % e banorëve të cilet mendojnë se në harkun kohor prej 5 vjetësh sasia e informacionit nga komuna është rritur	22 %			>50%
2. % e banorëve të cilët mendojnë se intesiteti i informacionit me mjetet e komunës është rritur	19.4 % ¹	25%	40%	>50%
3. % e banorëve që pohojne pjesëmarrjen e tyre në proceset vendim marrëse për hartimin e buxhetit, caktimin e investimeve dhe në marrjen e vendimeve me rëndësi për komunitetin.	15 %	30 %	40 %	>50 %
4. % e banorëve të cilët mendojnë se janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me kohën e kryerjes së shërbimeve nga administrata e komunës	16%	20%	30%	>50 %
5. % e banorëve të cilët janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me aftësinë e komunës për tu përgjigjur dhe zgjidhur problemet e tyre	13%	20%	30%	>50 %

¹ Këtu përfshihen mjete të tilla si: gazeta lokale, qendra e informimit në komunë, stendat (këndet) e njoftimit, mbledhjet e këshillit, kontakti me zyrtarë të komunës

Objektivi 1: Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit midis komunës, këshillit të komunës dhe kryepleqve		
Një nga elementet e mirë-qeverisjes ka qenë gjithmonë decentralizimi i vendim-marrjes dhe ekzekutimit, përcaktimi dhe ndarja e përgjegjësi të organeve apo individëve të ndryshëm brënda strukturave të qeverisjes vendore përmes hartimit dhe përdorimit të një kodi etike për komunën ku përfshihen dhe detajohen marrdhëniet komunë- keshill – kryepleqësi. Kjo është shoqëruar dhe me realizimin e takimeve/tavolinave të hapura për kryetarët e fshatrave dhe banorët e komunës me qëllim informimin, vlerësimin e nevojave dhe priorizimin e veprimeve dhe investimet e realizuara apo ato të planifikuara.		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
1. Përgatitja, aprovimi dhe vënia në përdorim e një kodi etike për komunën ku përfshihen dhe detajohen marrdhëniet komunë- keshillë – kryepleqësi si dhe konsolidohet pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Kontakti me njesi të tjera vendore të cilat kanë adaptuar një kod etike, ✚ Adaptimi i kodit të etikës për kushtet e komunës ✚ Aprovimi dhe zbatimi i kodit të etikës 	2006
2. Realizimi periodik i takimeve/tavolinave të rumbullakta me qëllim informimin e kryetarëve të fshatrave, këshillit të komunës dhe kryetarit për punën e kryer, investimet e realizuara, ato të planifikuara apo aktivitete të ndryshme.	✚ Vendimi i Këshillit të Komunës për thirrjen e mbledhjeve të hapura të Këshillit	2006
3. Realizimi i takimeve/tavolinave të rumbullakta me qëllim marrjen e informacionit nga kryepleqët për nevojat e fshatrave.		
4. Thirrja e kryetarëve të fshatrave dhe banorëve të spikatur në mbledhjet e këshillit të komunës dhe realizimi i seancave dëgjimore paraprirëse të mbledhjeve të këshillit me qëllim vendim-marrje të rëndësishme.		

Objektivi 2: Rritja e Transparencës		
Transparenca me komunitetin është parim themelor i aktivitetit vendim-marres dhe ekzekutiv të komunës e cila ka krijuar infrastrukturen e nevojshme për marrjen dhe dhënien e informacionit nëpërmjet publikimit në stenda apo nëpërmjet fletëpalosjeve lidhur me ndyshimet në strukturën e komunës, buxhetin, taksat dhe tarifën, investimet e bëra dhe ato të planifikuara, etj. Një person në administratën e komunës është ngarkuar posaçërisht për shpërndarjen e informacionit.		
Projektet/Hapat e Veprimit	Hapat Konkrete/Shënim	Deri në vitin:
1. Ngritja e stendës së informacionit në komunë	✚ Vendimi i Këshillit të Komunës për thirrjen e mbledhjeve të hapura të Këshillit	2006
2. Caktimi i një personi në stafin e komunës për të ofruar informacion tek komuniteti në zyrat e komunës.		
3. Afishimi i informacionit të nevojshëm (struktura e komunës, buxheti, taksat dhe tarifën, investimet e bëra dhe ato të planifikuara, etj..) në stendën e komunës.		
4. Organizimi i mbledhjeve të hapura/seancave dëgjimore për komunitetin gjatë miratimit të proceseve/aktiviteteve të rëndësishme që ndikojnë jetën e komunitetit.		

5. Nxitja e marrdhënieve me median lokale/kombëtare, të shkruar dhe vizive.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Takimi me autoritetet e medias me bazë në Korçë ✚ Parashtrimi i një kërkesë për të kërkuar pasqyrimin e ngjarjeve dhe aktiviteteve që zhvillohen në komunë ✚ Arritja e një marrëveshje me televizionin publik me bazë në Korçë 	2006
---	--	------

Objektivi3: Rritja e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje

Përmirësimi i komunikimit me të gjitha nivelet, rritja e transparencës, thithja e opinionit qytetar kanë kërkuar një staf dhe këshill komune të përgatitur si dhe mjetet e nevojshme për t'u realizuar. Për këtë qëllim, trajnimi i vazhdueshëm i administratës për funksionet që mbulon, trajnimi i këshilltarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, rolin dhe marrdhëniet me administratën si dhe aftësi komunikuese kanë qenë elementet kryesor për ngritjen e kapaciteteve. Funksionimi dhe kompletimi i arshivës me bazën e nevojshme materiale si dhe paisja e domosdoshme e komunës me kompjutera janë bërë elementet në aktivitetin a vazhdueshëm të komunës.

<i>Projektet/Hapat e Veprimit</i>	<i>Hapat Konkrete/Shënim</i>	<i>Deri në vitin</i>
1. Marrja e mendimit qytetar dhe e komunitetit nëpërmjet takimeve të hapura në fshatra me pjesëmarrjen e kryetarëve të fshatrave, kryetarit të komunës dhe antarëve të këshillit 2. Organizimi i mbledhjeve të hapura, anketimeve për marrjen e vendimeve të rëndësishme që ndikojnë në jetën e komunitetit 3. Përgatitja e herëpashershme e fletëpalosjeve për informimin e komunitetit.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Pjesëmarrja e kryetarëve të fshatrave dhe banorëve të spikatur në mbledhjet mujore të këshillit të komunës ✚ Organizimi i mbledhjeve të hapura për diskutimin dhe aprovimin e buxhetit vjetor ✚ Anketimi vjetor për vlerësimin e nevojave 	2006

Objektivi4: Përmirësimi i kapaciteteve per stafin dhe keshilltaret

Përmirësimi i komunikimit me të gjitha nivelet, rritja e transparencës, thithja e opinionit qytetar kanë kërkuar një staf dhe këshill komune të përgatitur si dhe mjetet e nevojshme për t'u realizuar. Për këtë qëllim, trajnimi i vazhdueshëm i administratës për funksionet që mbulon, trajnimi i këshilltarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, rolin dhe marrdhëniet me administratën si dhe aftësi komunikuese kanë qenë elementet kryesor për ngritjen e kapaciteteve. Funksionimi dhe kompletimi i arshivës me bazën e nevojshme materiale si dhe paisja e domosdoshme e komunës me kompjutera janë bërë elementet në aktivitetin e vazhdueshëm të komunës.

<i>Projektet/Hapat e Veprimit</i>	<i>Hapat Konkrete/Shënim</i>	<i>Deri në vitin</i>
1. Përgatitja dhe aprovimi i një rregullore të brendëshme për funksionimin e ekzekutivit dhe ndarjen e përgjegjësiave në mënyrë që të rritet efica dha efektiviteti i zyrtareve të administratës	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Kontakti me projektet e asistencës për Pushtetin Vendor me bazë në Qarkun e Korçës ✚ Angazhimi i një grupi pune për formulimin e rregullores ✚ Aprovimi në Këshill 	2006 2006 2007
2. Trajnimi i vazhdueshëm i administratës për funksionet që mbulon 3. Trajnimi i këshilltarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, rolin dhe marrdhëniet me administratën si dhe aftësi komunikuese.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Parashtrimi i kërkesës për trainim në Këshillin dhe strukturat e caktuara në administratën e qarkut në Korçë ✚ Regjistrimi dhe ndjekja e kurseve të trainimit që organizohen në qarkun e Korçës nga administrata e qarkut dhe projektet e asistencës 	2006
4. Paisja e domosdoshme e komunës me kompjutera.	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Eksplorimi i mundësive për financim nga buxheti i komunës ✚ Kontakti me projekte të asistencës dhe identifikimi i burimeve të mundshme të financimit 	2007

